



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

## KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 623 Akti

Nr. 453 Vendimi  
Tiranë, më 27.9.2021

### V E N D I M

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

<b>Brunilda Bektoshi</b>	Kryesuese
<b>Lulzim Hamitaj</b>	Relator
<b>Etleda Çiftja</b>	Anëtare

asistuar nga sekretare gjyqësore, znj. Orjanda Liçi, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Tonci Petkovic, në datën 23.9.2021, në Pallatin e Koncerteve (ish-Pallati i Kongreseve), salla B, kati 0 (*underground*), Tiranë, mori në shqyrtim në seancën dëgjimore publike çështjen që i përket:

**SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT:**

**Znj. Diamela Goxha**, me detyrë gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kavajë.

**OBJEKTI:**

**Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.**

**BAZA LIGJORE:**

**Neni 179/b dhe nenet A, Ç, D, DH dhe E të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë**, miratuar me ligjin nr. 76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar.

**Ligji nr. 84/2016**, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

**Ligji nr. 44/2015**, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”.

**Ligji nr. 49/2012**, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar.

## **TRUPI GJYKUES I KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT,**

pasi dëgjoi arsyetimin ligjor dhe rekomandimin e relatorit të çështjes, subjektin e rivlerësimit, vëzhguesin ndërkombëtar, si dhe pasi shqyrtoi dhe diskutoi mbi tërësinë e çështjes që i përket rivlerësimit kalimtar të subjektit të rivlerësimit Diamela Goxha, me detyrë gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kavajë, e cila në seancën dëgjimore publike të datës 23.9.2021, kërkoi konfirmimin në detyrë,

### **V Ë R E N:**

#### **I. RRETHANAT E ÇËSHTJES**

- i. Znj. Diamela Goxha ka dorëzuar dokumentacionin e kërkuar në zbatim të ligjit nr. 84/2016, në: Inspektoratin e Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim ILDKPKI); Drejtorinë e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (në vijim DSIK); si dhe pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor (në vijim KLGJ).
- ii. Pika 4, e nenit 179/b, të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, miratuar me ligjin nr. 76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, parashikon se: *“Të gjithë gjyqtarët dhe prokurorët në detyrë [...] do të rivlerësohen, ex officio”*.
- iii. Bazuar në pikën 2, të nenit 14, të ligjit nr. 84/2016 dhe në rregulloren “Për procedurat e zhvillimit të shortit në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit”, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (në vijim Komisioni) ka hedhur shortin në datën 15.12.2020, nga i cili rezultoi se për subjektin e rivlerësimit Diamela Goxha procesi i rivlerësimit do të kryhej nga trupi gjykues i përbërë nga komisionerët Brunilda Bekteshi, Lulzim Hamitaj dhe Etleda Çiftja.
- iv. Trupi gjykues i sipërpërmendur, pasi administroi dhe shqyrtoi të tre raportet e përcjella nga organet ndihmëse, sipas parashikimeve të neneve 31 - 44 të ligjit nr. 84/2016, me vendimin nr. 1, datë 23.12.2020, vendosi: (i) të fillojë hetimin administrativ të thelluar dhe të gjithanshëm sipas nenit 45 të po këtij ligji; dhe (ii) me mirëkuptim, të caktohej kryesuese e trupit gjykues komisionere Brunilda Bekteshi. Gjithashtu, në këtë mbledhje, anëtarët e trupit gjykues deklaruan se nuk ishin në kushtet e konfliktit të interesit me subjektin e rivlerësimit në fjalë. Procesi i rivlerësimit për subjektin Diamela Goxha u krye me përparësi për shkak të kandidimit të kësaj të fundit si gjyqtare në Gjykatën e Apelit<sup>1</sup>.
- v. Nëpërmjet vendimit nr. 2, datë 13.7.2021, Komisioni vendosi të administrojë dokumentet nga dosja e subjektit të rivlerësimit O. G. (motra e subjektit), me qëllim përdorimin e tyre në procesin e rivlerësimit për subjektin Diamela Goxha.
- vi. Pas përfundimit të fazës hetimore mbi rivlerësimin e subjektit Diamela Goxha, me vendimin nr. 3, datë 27.7.2021, trupi gjykues vendosi të mbyllë hetimet dhe në bazë të nenit 4 të ligjit nr. 84/2016 vlerësoi që procesi i rivlerësimit për këtë subjekt të bazohej në të tria kriteret e rivlerësimit të parashikuara nga ligji nr. 84/2016.
- vii. Komisioni, në datën 29.7.2021, e njoftoi subjektin e rivlerësimit mbi rezultatet e hetimit kryesisht – duke e ftuar atë për t’u njohur me dosjen dhe me provat e administruara nga

<sup>1</sup>Sipas njoftimit të bërë nga KLGJ-ja me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 6.5.2021.

Komisioni, në përputhje me nenin 47 të ligjit nr. 84/2016 dhe nenet 35 - 40 dhe 45 - 47 të Kodit të Procedurave Administrative, si dhe për të paraqitur shpjegimet dhe për të provuar të kundërtën e rezultateve të kristalizuara në fund të hetimit administrativ, duke i dhënë kohë për t'u njohur me dosjen dhe për të paraqitur qëndrimin e saj, në datën 19.8.2021.

- viii. Subjekti i rivlerësimit, në datën 12.8.2021, pasi është njohur me rezultatet e hetimit administrativ përmes postës elektronike ka kërkuar kohë shtesë për paraqitjen e mbrojtjes së saj. Për sa më sipër, Komisioni, duke mbajtur në vëmendje edhe veçantinë e muajit gusht dhe periudhën e pushimeve vjetore, në rrugë përjashtimore, vlerësoi të shtyjë afatin për paraqitjen e përgjigjeve/prapësimeve dhe dokumenteve përkatëse deri në datën 13.9.2021.
- ix. Subjekti i rivlerësimit paraqiti shpjegimet mbi rezultatet e hetimit kryesisht, në afatin e ri të përcaktuar nga Komisioni. Në vijim, në datën 20.9.2021, trupi gjykues, me vendimin nr. 4, vendosi të ftojë, përmes postës elektronike, subjektin e rivlerësimit në seancë dëgjimore, të caktuar në datën 23.9.2021, në përputhje me nenin 55 të ligjit nr. 84/2016.

## **II. SEANCA DËGJIMORE**

- i. Seanca dëgjimore për subjektin e rivlerësimit Diamela Goxha u zhvillua në përputhje me kërkesat e nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Tonci Petkovic, si dhe me pjesëmarrjen e subjektit.
- ii. Në vijim, pasi dëgjoi relacionin, subjekti Diamela Goxha parashitri shpjegimet përkatëse lidhur me rezultatet e hetimit kryesisht, si dhe mbi procesin e rivlerësimit të kryer ndaj saj, duke iu referuar edhe shpjegimeve të paraqitura më herët me shkrim.
- iii. Në fund të seancës dëgjimore, subjekti i rivlerësimit kërkoi konfirmimin në detyrë.
- iv. Seanca dëgjimore e datës 23.9.2021 u mbyll, për të rifilluar më 27.9.2021 për shpalljen e vendimit.

## **III. QËNDRIMI I SUBJEKTIT TË RIVLERËSIMIT**

Subjekti i rivlerësimit ka qenë bashkëpunues në procesin e rivlerësimit, duke u përgjigjur në kohë, kur i është kërkuar – sipas parashikimeve të nenit 48 të ligjit nr. 84/2016 – përgjatë gjithë procedurës së hetimit administrativ.

## **IV. HETIMI ADMINISTRATIV I KRYER NGA KOMISIONI**

Bazuar në nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni kreu një hetim dhe vlerësim të të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit, duke marrë në analizë: (i) provat e dorëzuara nga subjekti i rivlerësimit në ILDKPKI në deklaratën e pasurisë për rivlerësimin kalimtar *Vetting*; (ii) raportin e dorëzuar në Komision nga ILDKPKI-ja; (iii) raportin mbi kontrollin e figurës të dorëzuar në Komision nga DSIK-ja; (iv) provat shkresore/dokumentet e administruara nga organet publike dhe private në përputhje me nenet 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016; (v) raportin e përpiluar nga KLGJ-ja; (vi) deklaratimet dhe përgjigjet e subjektit të rivlerësimit të bëra me anë të komunikimit elektronik; (vii) shpjegimet me shkrim dhe dokumentacionin mbështetës të paraqitur nga

subjekti i rivlerësimit pas njoftimeve të mbylljes së hetimeve administrative; (viii) argumentimet e paraqitura në seancën dëgjimore; si dhe (ix) faktet e njohura botërisht.

## **A. VLERËSIMI I PASURISË**

### **A/1. VLERËSIMI I PASURISË NGA ILDKPKI-ja**

Bazuar në nenet 30 - 33 të ligjit nr. 84/2016, ILDKPKI-ja ka dërguar në Komision raportin lidhur me deklaratimet dhe vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit, duke konstatuar se:

- *deklarimi është i saktë në përputhje me ligjin;*
- *ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;*
- *nuk ka kryer fshehje të pasurisë;*
- *nuk ka kryer deklarim të rremë;*
- *subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesit.*

Komisioni ka hetuar në mënyrë të pavarur mbi çdo informacion dhe konkluzion të institucionit të sipërpërmendur, ashtu sikurse mbi të gjitha faktet dhe informacionet e marra nga çdo subjekt i së drejtës, në përputhje me nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016.

Hetimi administrativ në lidhje me vlerësimin e pasurisë ka konsistuar në: verifikimin e vërtetësisë së deklaratimeve në lidhje me gjendjen pasurore të subjektit dhe personave të lidhur; verifikimin e burimeve të krijimit të të ardhurave dhe shpenzimeve, me qëllim evidentimin e mungesës së mundshme të burimeve të mjaftueshme financiare për të justifikuar pasuritë; evidentimin e ndonjë fshehjeje të mundshme të sendeve në pronësi ose përdorim; evidentimin e ekzistencës së mundshme të deklaratimeve të rreme apo të ndonjë konflikti të interesave, të parashikuara nga pika 5, e nenit 33, të ligjit nr. 84/2016.

### **A/2. RIVLERËSIMI I PASURISË NGA KOMISIONI**

#### **1. Apartament banimi, në përdorim, në rrugën “I. Q.”, Tiranë**

1. Subjekti i rivlerësimit, në deklaratën *Vetting*, ka deklaruar si adresë vendbanimi: apartamenti nr. \*\*\*<sup>2</sup>, k. \*\*\*, Njësia Administrative Nr. \*\*\*, në rrugën “I. Q.”, Tiranë. Në përgjigje të pyetësorit nr. 1, të dërguar nga Komisioni, subjekti ka deklaruar se në këtë apartament banon së bashku me prindërit dhe motrën e saj, si dhe ka shpjeguar se ky apartament është përfituar nga babai i saj nëpërmjet kontratës së shitblerjes nr. \*\*\*, datë 1.9.1997, të cilën e ka paraqitur në cilësinë e provës<sup>3</sup>.
2. Përgjatë procesit të rivlerësimit ka rezultuar se në kontratën e nënshkruar nga subjekti me “Raiffeisen Bank”, si dhe në marrëveshjen e saj të huas, në llogarinë rrjedhëse (*overdraft*) në “Credins Bank”, të lidhur në datën 22.10.2013, subjekti ka deklaruar si adresë banimi të njëjtën adresë me atë të pasurisë në analizë, përveç numrit të apartamentit i cili është

<sup>2</sup>Në kontratën e nënshkruar nga subjekti me “Raiffeisen Bank”, si dhe në marrëveshjen e nënshkruar me “Credins Bank”, ka rezultuar se në adresën e vendbanimit të deklaruar prej saj, numri i apartamentit ka qenë \*\*\*. Ndërkohë referuar certifikatës personale të subjektit, të lëshuar nga gjendja civile në datën 16.2.2021, si dhe referuar adresës së deklaruar nga subjekti në DIPP-të ndër vite, ka rezultuar si adresë vendbanimi apartamenti nr. \*\*\*. Gjithashtu nga verifikimi i kartelës së pasurisë në sistemin multifunksional të ASHK-së ka rezultuar apartamenti me nr. \*\*\*.

<sup>3</sup>Nga informacioni i përcjellë nga Ministria e Drejtësisë/Spektori i Rregullimit të Profesioneve të Lira, Regjistri Noterial, nëpërmjet shkresës nr. \*\*\* prot., datë 23.3.2021, nuk kanë rezultuar kontrata me palë subjektin e rivlerësimit.

\*\*\*, pra i ndryshëm nga kjo pasuri që mban numrin \*\*\*.

3. Në përgjigje të pyetësorit nr. 2, subjekti ka deklaruar se nuk ka ndryshuar asnjëherë adresë banimi dhe se bëhet fjalë për një pasaktësi për shkak të mospasjes së një numri të saktë të identifikimit të pallatit, si dhe ndryshimit të sistemit të adresave. Gjithashtu ka deklaruar se nga momenti i fillimit të detyrës dhe në vijim, prindërit nuk kanë kryer investime apo shpenzime mobilimi dhe nuk disponojnë pasuri të paluajtshme apo të drejta reale mbi to, përveç apartamentit në fjalë që është blerë dhe mobiluar prej tyre në vitin 1997.
4. Në mbështetje të deklarimit të saj, subjekti ka paraqitur një deklaratë të thjeshtë të datës 19.7.2021, nga shoqëria ndërtuese dhe shitëse “T.” sh.p.k., në të cilën është cituar se për shkak të mungesës së numrit të godinës është përdorur nr. \*\*\*, ndërsa aktualisht kjo ndërtesë mban nr. \*\*\* dhe numri i vendosur i apartamentit është \*\*\*. Subjekti ka paraqitur, gjithashtu, vërtetim<sup>4</sup> nga Njësia Bashkiake Nr. \*\*\*, në të cilin është konfirmuar se familja e z. F. G. banon në adresën: rr. “I. Q.”, ap. \*\*\*, k. \*\*\*, që nga data 10.12.1998.
5. Përgjatë hetimit administrativ, Komisioni është informuar nga Agjencia Shtetërore e Kadastrës<sup>5</sup>, e cila ka bërë me dije se nuk kanë rezultuar pasuri të paluajtshme, të regjistruara në pronësi të subjektit apo personave të lidhur, veç asaj të deklaruar nga subjekti. Gjithashtu, nga verifikimi *online*, në sistemin multifunksional të ASHK-së për institucionet, Komisioni ka arritur në të njëjtin konstatim, me atë të përcjellë nga ASHK-ja. Konkretisht, pasuria në fjalë me nr. \*\*\*, vol. \*\*\*, f. \*\*\*, z. k. \*\*\*, ka rezultuar e regjistruar sipas kontratës së shitblerjes të lidhur midis babait të subjektit të rivlerësimit z. F.G.<sup>6</sup> dhe shoqërisë ndërtimore “T.” sh.p.k., të përfaqësuar nga z. E. P.. Çmimi i përcaktuar në këtë kontratë ka qenë në vlerën 56,000 USD, të likuiduar në datën 25.8.1997.
6. Nga FSHU-ja<sup>7</sup> dhe UKT-ja<sup>8</sup> është bërë me dije për Komisionin se në emër të subjektit të rivlerësimit dhe të prindërve të saj nuk kanë rezultuar kontrata të lidhura për shërbime të energjisë elektrike dhe ujësjellësit.
7. Nëpërmjet pyetësorit nr. 2, Komisioni i ka kërkuar subjektit të paraqesë kontratat e lidhura për shërbime/furnizime të energjisë elektrike dhe të ujit për apartamentin në të cilin ka deklaruar se ka banuar. Në përgjigje të pyetësorit, subjekti ka paraqitur librezën e energjisë elektrike dhe atë të ujit të pijshëm për pasurinë e sipërcituar, në të cilat janë të shënuara numrat e kontratave respektive. Gjithashtu, ka sqaruar se në librezën e energjisë elektrike, si rezultat i një gabimi material në emrin e babait të saj, në vend të emrit F. është pasqyruar

<sup>4</sup>Vërtetim nr. \*\*\* prot., datë 14.7.2021, i Njësies Bashkiake Nr. \*\*\*.

<sup>5</sup>ASHK Tirana Jug, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 23.4.2021, ka bërë me dije se subjekti i rivlerësimit dhe personat e tjerë nuk rezultojnë të kenë pasuri dhe/apo të jenë vetë deklarues në ndonjë praktikë legalizimi, duke cituar mes të tjerash edhe z. k. \*\*\*, në të cilën ndodhet pasuria në fjalë.

<sup>6</sup>Nga hetimi administrativ ka rezultuar se në llogari të babait të subjektit të rivlerësimit, z. F. G., janë transferuar shumat e parave, përkatësisht 39,999 euro në “Raiffeisen Bank” dhe 20,000 euro në “Intesa Sanpaolo Bank”, nga noter E. H. person fizik, me përshkrimin “kontratë shitjeje me kusht e pasurisë së paluajtshme nr. \*\*\*, datë 9.12.2016”. Po ashtu, nga dokumentacioni i disponuar ka rezultuar se janë kryer disa pagesa bankare/derdhje *cash*, nga nëna e subjektit, me nga 10,000 euro/secila, jashtë periudhës së rivlerësimit, në favor të shoqërisë ndërtuese “E.” sh.p.k., me përshkrimin “pagesë për kësht apartamenti sipas kontratës nr. \*\*\*, datë 13.5.2020”. Ndërkohë, nga përgjigjja e Ministrisë së Drejtësisë, Sektori i Rregullimit të Profesioneve të Lira, nuk ka rezultuar ndonjë kontratë e nënshkruar nga prindërit e subjektit me referencat e cituara në përshkrim të transfertave bankare të sipërpërmendura.

<sup>7</sup>Me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 2.4.2021.

<sup>8</sup>Me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 30.3.2021.

emri F.<sup>9</sup>.

8. Duke konsideruar se apartamenti në fjalë është blerë mbi 15 vjet më herët nga emërimi i subjektit të rivlerësimit si gjyqtar, si dhe duke pasur në vëmendje qëndrimin e mbajtur nga Kolegji i Posaçëm i Apelit në vendimin nr. 7/2020, Komisioni vlerësoi se nuk kishte arsye për kryerjen e hetimeve/verifikimeve të mëtejshme, lidhur me burimet e krijimit të kësaj pasurie nga prindërit e subjektit të rivlerësimit, vetëm për faktin se apartamenti *de quo* është përdorur edhe nga subjekti.

## **2. Automjet në bashkëpronësi, me vlerë totale 980,000 lekë**

9. Subjekti ka deklaruar për herë të parë në deklaratën e interesave private përpara fillimit të detyrës në vitin 2012, si dhe më pas në deklaratën Vetting, automjetin tip “Volkswagen 1KP Golf”, prodhim i vitit 2005, me targa \*\*\*, të regjistruar në DPSHTRR- në<sup>10</sup> Tiranë, në datën 26.10.2011, në bashkëpronësi me motrën e saj, me pjesë takuese në masën 50%.
10. Në mbështetje të sa më sipër, subjekti ka paraqitur si dokument provues kontratën e shitblerjes së automjetit në analizë me nr. \*\*\*, e datës 24.10.2011, ku blerës kanë rezultuar subjekti dhe shtetasja O. G.<sup>11</sup>, ndërsa shitës ka qenë shtetasi A. K.. Çmimi i blerjes i përcaktuar në kontratë ka qenë në vlerën 980,000 lekë.
11. Si burim për krijimin e kësaj pasurie, për pjesën e saj takuese të investimit në masën ½ të çmimit të përcaktuar në kontratë, në deklaratën Vetting subjekti ka deklaruar:
  - a. të ardhura nga kursime personale;
  - b. bursë nga Shkolla e Magjistraturës;
  - c. bursë nga Fakulteti i Drejtësisë.
12. Ndërsa në lidhje me pjesën takuese të motrës së saj në masën ½ e çmimit të automjetit, në përgjigje të pyetësorit nr. 2, subjekti ka deklaruar si burim kontributin në lekë të dhënë nga prindërit e tyre<sup>12</sup>.
13. Nga Drejtoria e Përgjithshme e Transportit Rrugor<sup>13</sup> është vënë në dispozicion dosja e automjetit<sup>14</sup> në analizë, nga e cila ka rezultuar se automjeti në fjalë është blerë fillimisht nga shtetasi A. K. në shtetin gjerman, nëpërmjet faturës së datës 15.6.2011, kundrejt çmimit prej 3,500 euro dhe në datën 5.7.2011 është paguar tarifa doganore në vlerën 280,995 lekë. Referuar të dhënave të pasqyruara në këtë dosje ka rezultuar se investimi

<sup>9</sup>Subjekti ka sqaruar, në përgjigje të pyetësorit nr. 2, se në kohën e blerjes së apartamentit kontratat e furnizimit me energji elektrike dhe ujë të pijshëm nuk kanë qenë të formalizuara me kontratë dhe detyrimet për to nuk figurojnë të regjistruara në sistemin e FSHU-së dhe UKT-së para viteve 2006 - 2007.

<sup>10</sup>Referuar certifikatës së pronësisë së mjetit rrugor të datës 26.10.2011.

<sup>11</sup>Motra e subjektit të rivlerësimit.

<sup>12</sup>Në deklaratën përpara fillimit të detyrës dhe deklaratës Vetting, të subjektit të rivlerësimit O. G., si burim krijimi për pasurinë në fjalë është deklaruar dhuratë nga prindërit.

<sup>13</sup>Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 24.3.2020.

<sup>14</sup>Përgjatë procesit të rivlerësimit, nga të dhënat në sistemin TIMS ka rezultuar se subjekti ka udhëtuar me disa automjete të ndryshëm nga ai në pronësi/përdorim, përkatësisht me ato me targa: \*\*\*, \*\*\*, \*\*\*, \*\*\*, \*\*\*, \*\*\*. Komisioni ka kryer verifikimin online në sistemin e AMF-së, me qëllim evidentimin e pronarëve të automjeteve të sipërcituar, si dhe ka kërkuar informacion (nëpërmjet shkresave nr. \*\*\* prot., dhe nr. \*\*\* prot., të datës 28.5.2021) nga Gjykatat e Rretheve Gjyqësore Kavajë dhe Berat, me qëllim verifikimin e konfliktit të mundshëm të interesit, të subjektit me personat me të cilët ajo ka udhëtuar (referuar të dhënave të rezultuara nga sistemet TIMS dhe AMF). Nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kavajë, nëpërmjet shkresës me nr. \*\*\* prot., datë 7.6.2021 dhe nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Berat, nëpërmjet shkresës me nr. \*\*\* prot., datë 3.6.2021, është bërë me dije se nuk kanë rezultuar çështje të gjykuara nga subjekti, me palë shtetasit me të dhënat e cituara në kërkesën e dërguar nga Komisioni.

total i kryer nga pala shitëse ka qenë në vlerën 765,045 lekë. Pas një harku kohor rreth 3 muaj, i është shitur subjektit dhe motrës së saj në vlerën 980,000 lekë<sup>15</sup>.

## **2.1. Lidhur me burimet e krijimit të pasurisë së llojit automjet**

14. Nga hetimi administrativ i kryer nga Komisioni lidhur me burimin e krijimit të kësaj pasurie, ka rezultuar se subjekti i rivlerësimit dhe motra, shtetasja O. G. kanë qenë bashkinvestitore në masën ½ pjesë takuese secila, të cilat analizohen në mënyrë të detajuar në vijim.

### **2.1.1. Lidhur me burimet e krijimit të pasurisë për pjesën takuese të subjektit**

15. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur nga subjekti ka rezultuar se të ardhurat e përfituara prej saj, nga bursa e dhënë nga Shkolla e Magjistraturës përgjatë periudhës tetor 2010 – tetor 2011 dhe të tërhequra prej saj, përgjatë kësaj periudhe, kanë qenë në vlerën 521,000 lekë.
16. Ndërsa, të ardhurat e përfituara nga subjekti nga bursa e dhënë nga Fakulteti i Drejtësisë<sup>16</sup>, kanë qenë në vlerën 72,000 lekë. Nga analiza e lëvizjeve në llogaritë bankare të subjektit, ka rezultuar se ato janë tërhequr prej saj në datën 10.11.2011, pra pas blerjes së automjetit në analizë<sup>17</sup>.

### **2.1.2 Lidhur me burimet e krijimit për pjesën takuese të motrës së subjektit**

17. Në lidhje me të ardhurat nga paga të motrës së subjektit, nga analiza e lëvizjeve në llogaritë bankare të saj ka rezultuar se gjatë viteve 2010 dhe 2011 ka tërhequr shumën 788,000 lekë<sup>18</sup>.
18. Në lidhje me kontributin e dhënë nga prindërit për blerjen e pasurisë, përgjatë hetimit administrativ të kryer lidhur me të ardhurat dhe burimet e tyre, ka rezultuar se prindërit e subjektit dhe vëllai i saj kanë ushtruar aktivitete tregtare ndër vite<sup>19</sup>.
19. Përgjatë procesit të rivlerësimit, në përgjigje të pyetësorit nr. 2, subjekti ka shpjeguar se ndonëse vëllai i saj, E. G., është shkëputur prej familjes në vitin 2012, sërish ka vijuar të kontribuojë në shpenzimet e jetesës së prindërve. Gjithashtu, ka sqaruar se babai i saj ka zotëruar shoqërinë tregtare “G.” sh.p.k., të krijuar në vitin 1996, aktiviteti tregtar i së cilës ka vijuar deri në vitin 2000. Në vijim, në periudhën 2001 – 2010, babai i saj ka qenë administrator dhe ortak i vetëm i shoqërisë “D.” sh.p.k., për të cilën subjekti ka paraqitur

---

<sup>15</sup>AMF-ja, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 28.8.2020, ka konfirmuar mbulimin me sigurim të automjetit në pronësi të subjektit dhe motrës së saj, duke filluar nga data 4.11.2012.

<sup>16</sup>Subjekti ka paraqitur bashkëngjitur deklaratën *Vetting*, shkresën me nr. \*\*\* prot., datë 25.1.2017, nga Fakulteti i Drejtësisë, sipas së cilës është trajtuar nga ky fakultet me bursë për vitin shkollor 2007 – 2008, në shumën 72,000 lekë.

<sup>17</sup>Referuar kontratës së shitblerjes së automjetit, ka qenë kusht i përcaktuar në kontratë se likuidimi i çmimit do të kryhej pas regjistrimit të mjetit në pronësi të subjektit dhe motrës së saj.

<sup>18</sup>Referuar përgjigjes së ardhur për subjektin e rivlerësimit O. G., me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 10.12.2020, sipas së cilës gjatë vitit 2010 është tërhequr shuma prej 548,000 lekësh dhe gjatë vitit 2011 është tërhequr shuma prej 240,000 lekësh. Përgjatë kësaj periudhe, znj. O. G. ka qenë e punësuar në Ministrinë e Punëve të Brendshme, në shërbimin për çështjet e brendshme dhe ankesat sipas vërtetimit nr. \*\*\* prot., datë 21.10.2016, i lëshuar nga ky institucion.

<sup>19</sup>Nëpërmjet shkresës nr. \*\*\* prot., datë 13.7.2021, Komisioni ka kërkuar informacion nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve në lidhje me shpërndarje të mundshme të dividendëve nga shoqëritë “D.” sh.p.k., “E.” sh.p.k., “K. & T.” sh.p.k., si dhe personi fizik “E. G.”. Ndonëse aktivitetet tregtare të babait dhe vëllezërve të subjektit kanë realizuar fitime ndër vite, nga DPT-ja<sup>19</sup>, me shkresat e dërguara pas mbylljes së hetimeve, është përcjellë informacioni/dokumentacioni nga i cili ka rezultuar se – përveç fitimeve të personit fizik “E. G.”, të cilat nuk i nënshtrohen shpërndarjes në formën e dividendit – nuk kanë rezultuar dividendë të shpërndarë nga asnjëra prej shoqërive të sipërcituara, ndër vite.

shkresën me nr. \*\*\* prot., datë 19.7.2021, të DRT-së Tiranë, ku citohet se aktiviteti i shoqërisë “D.” sh.p.k. është pezulluar në datën 23.6.2010, ndërkohë që përgjatë periudhës 2003 – 2010, ka realizuar fitimet si vijojnë:

- a. viti 2003 – qarkullimi 2,212,197 lekë dhe fitimi 326,200 lekë;
  - b. viti 2004 – qarkullimi në vlerën 2,070,471 lekë dhe fitimi në vlerën 104,396 lekë;
  - c. viti 2005 – qarkullimi në vlerën 932,400 lekë dhe fitimi në vlerën 104,396 lekë;
  - d. viti 2006 – qarkullimi në vlerën 10,163,029 lekë dhe ka rezultuar me humbje;
  - e. viti 2007 – qarkullimi në vlerën 45,030,726 lekë dhe fitimi në vlerën 1,659,274 lekë;
  - f. viti 2008 – qarkullimi në vlerën 20,339,968 lekë dhe fitimi në vlerën 5,362,969 lekë;
  - g. viti 2009 – qarkullimi në vlerën 9,136,174 lekë dhe fitimi në vlerën 298,850 lekë;
  - h. viti 2010 – qarkullimi në vlerën 596,745 lekë dhe ka rezultuar me humbje.
20. Nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve (në vijim DPT), me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 20.4.2021, është bërë me dije se babai i subjektit ka rezultuar administrator dhe aksioner i vetëm i shoqërisë “D.” sh.p.k., e regjistruar në datën 13.1.2001 dhe me status aktual “pasiv”, prej datës 6.5.2016, si dhe ka vënë në dispozicion të Komisionit deklaratat e tatimit për këtë shoqëri për vitet 2003 – 2010 dhe 2014 – 2016. Gjithashtu, DPT-ja ka bërë me dije se shtetasja Xh. G., nëna e subjektit, ka rezultuar administratore në shoqërinë “M.” sh.p.k., me datë regjistrimi 18.5.2010 dhe me status pasiv prej datës 13.12.2011, si dhe ka informuar se për këtë shoqëri nuk ka deklarata tatimore të ngarkuara në sistemin e këtij institucioni dhe se shtetasi E. G., vëllai i subjektit ka ushtruar aktivitet tregtar, i regjistruar si person fizik, në datën 24.2.2010. Nga kontrolli i kryer në faqen zyrtare të QKB-së, ka rezultuar se nuk janë depozituar bilancet/pasqyrat financiare të kësaj shoqërie deri në vitin 2014.
21. Subjekti ka paraqitur si provë një dokument të printuar nga faqja zyrtare “taksat.dpttv.gov.al”, në të cilën janë të evidentuara taksat dhe tarifat vendore të paguara nga kjo shoqëri ndër vite. Nga analiza e këtij dokumenti ka rezultuar se për vitet 2010 dhe 2011, shoqëria ka paguar taksën e biznesit të vogël në 4 këste, prej 68,000 lekësh/vit<sup>20</sup>. Referuar legjislacionit në fuqi<sup>21</sup> të kohës, kjo lloj takse ka qenë fikse dhe e përcaktuar në bazë të llojit të aktivitetit dhe qarkullimit të realizuar. Në kushtet e mungesës së pasqyrave financiare për këtë shoqëri ishte objektivisht e pamundur të përcaktohej fitimi i mundshëm i realizuar nga aktiviteti tregtar i kryer.
22. Gjithashtu, përgjatë hetimit administrativ ka rezultuar se babai i subjektit ka qenë aksioner me 100% të aksioneve, në shoqërinë “K. & T.” sh.p.k., gjatë periudhës 21.4.2014 – 29.3.2018. Referuar ekstraktit historik të kësaj shoqërie, shtetasi F. G. i janë kaluar aksionet në vitin 2014 me anë të dhurimit nga djali i tij, shtetasi S. G.. Në vitin 2018, aksionet i janë dhuruar sërish këtij të fundit. Nga analiza e dokumentacionit të administruar ka rezultuar se shoqëria “K. & T.” sh.p.k., gjatë vitit 2014, ka realizuar qarkullim monetar në vlerën 6,884,648 lekë dhe fitim në vlerën 623,600 lekë. Në vijim, në datën 21.5.2015, shoqëria ka kaluar në status pasiv.

<sup>20</sup>Për vitin 2010 është paguar shuma prej 62,333.33 lekësh, pasi është paguar në mënyrë përpjesëtimore për dy muaj të 3-mujorit të parë të vitit, për shkak të regjistrimit në muajin shkurt.

<sup>21</sup>Ligji nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar.



23. Komisioni i është ridrejtuar DPT-së me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 13.7.2021, për të informuar në lidhje me shpërndarje të mundshme të dividendëve në favor të prindërve të subjektit, pasi ndonëse shoqëritë e mësipërme kanë realizuar fitime ndër vite, nuk ishte provuar shpërndarja e dividendëve të këtyre shoqërive, në favor të aksionerëve dhe pagimi i detyrimeve tatimore mbi dividendin për të evidentuar shumat konkrete të të ardhurave të përfituara prej aksionerit, e të kaluara më tej në ekonominë familjare, si dhe pajtueshmërinë e tyre me kërkesat e nenit D të Aneksit të Kushtetutës.
24. Komisioni ka përllogaritur edhe shpenzimet e jetesës të familjes së subjektit<sup>22</sup> dhe, në përfundim, ka rezultuar se të ardhurat e evidentuara/dokumentuara nga Komisioni përgjatë hetimit administrativ prej 1,309,000 lekësh janë edhe më të ulëta se shpenzimet e jetesës së subjektit dhe familjes së saj prej 1,366,200 lekësh, duke rezultuar kështu në një pamundësi totale për blerjen e pasurisë në analizë, me mungesë të burimeve të ligjshme financiare në vlerën totale prej – 980,000 lekësh të pasurisë automjet, për të cilën Komisioni i ka kaluar barrën e provës.

#### **Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit**

25. Subjekti i rivlerësimit, pasi është njohur me rezultatet e hetimit administrativ për këtë pasuri, përveç dokumentacionit që ka depozituar së bashku me prapësimet, ka pretenduar se duke qenë se automjeti është blerë përpara fillimit të detyrës së saj si gjyqtare, analiza financiare duhet të kryhet vetëm për pjesën e saj të investimit në këtë pasuri, në vlerën prej 490,000 lekësh, ndërsa për pjesën tjetër të investimit të kryer nga motra, e cila është gjithashtu subjekt rivlerësimi, është shprehur se barra e provës i takon kësaj të fundit, përgjatë procesit të saj të rivlerësimit.
26. Gjithashtu, subjekti ka kërkuar që të përllogariten vetëm shpenzimet e saj dhe jo të të gjithë familjes, pasi shpenzimet e familjes nuk janë mbuluar nga të ardhurat e saj nga bursa. Gjithashtu, subjekti ka pretenduar se prindërit e saj nuk duhet të konsiderohen nga Komisioni si persona të lidhur me të, por si të tjerë të lidhur.
27. Për të provuar burimin e ligjshëm të të ardhurave të familjes së saj, subjekti ka paraqitur bilancet e aktivitetit të vëllait “E. G.” person fizik, për vitet 2010 dhe 2011, si dhe ka kërkuar që të shtohen të ardhurat nga fitimi *neto* të aktivitetit të shoqërisë, së bashku me pagat e vëllait në analizën e familjes.
28. Subjekti ka kërkuar që analiza të kryhet deri në muajin tetor 2011, kur është blerë automjeti, duke ulur shpenzimet e përllogaritura me dy muaj ose të llogariten edhe të ardhurat deri në fund të këtij viti, si dhe ka paraqitur në cilësinë e provës dokumentacionin:
- deklarata e tatimit mbi të ardhurat e biznesit të vogël “E. G.” person fizik, për vitin 2011;
  - vërtetim mbi bazën e vlerësueshme për pagat e vëllait E. G., për vitet 2010 - 2011;
  - shkresë nr. \*\*\* prot., datë 3.9.2021, nga DRT-ja Tiranë për të dhënat mbi të ardhurat e realizuara nga person fizik “E. G.”, në vitet 2013 dhe 2014, si dhe pasqyrat financiare

---

<sup>22</sup>Bazuar në përgjigjet e pyetësorit, përbërja familjare ka qenë me 5 pjesëtarë deri në vitin 2012 (përfshirë subjektin, motrën, prindërit dhe vëllain e subjektit, z. E. G.), e më pas me 4 pjesëtarë sipas të dhënave zyrtare të INSTAT-it për frymë.

të nxjerra nga arshiva e DRT-së Tiranë për vitet 2011 – 2012, nga ku kanë rezultuar fitimet prej 561,000 lekësh në vitin 2010 dhe 612,000 lekë në vitin 2011.

### **Vlerësimi i trupit gjykues**

29. Trupi gjykues konsideron të pabazuar pretendimin e subjektit lidhur me kryerjen e analizës vetëm për pjesën e saj takuese prej 50% të investimit në këtë pasuri, për sa kohë edhe të drejtat reale mbi gjysmën tjetër të pronësisë së automjetit në analizë i përkasin një anëtari të familjes së subjektit, të përshkruar në certifikatën familjare. Në këto kushte, subjekti duhet të shpjegonte dhe justifikonte burimin e krijimit për të gjithë pasurinë në fjalë, sikurse do të ndodhte edhe sikur e tërë pasuria të ishte blerë nga motra e subjektit, pasi analiza financiare është familjare dhe përshin të gjitha të ardhurat, shpenzimet dhe investimet në nivel familjar dhe jo individual. Ky qëndrim bazohet në dispozitat ligjore përkatëse që diktojnë përlllogaritjen e mundësive financiare në rang familjar. Gjithashtu, ky vlerësim konfirmohet në mënyrë indirekte edhe nga jurisprudenca e Kolegjit të Posaçëm të Apelit<sup>23</sup>, që me qëndrimin e vet qartëson edhe rastet e personave që, ndonëse nuk janë pjesë e certifikatës familjare të subjektit, duhet t'i nënshtrohen verifikimit të burimeve financiare në lidhje me pasuritë apo transaksionet, që përbëjnë një marrëdhënie interesi me subjektin. Lidhur me këtë situatë, Kolegji i Posaçëm i Apelit, në vendimin nr. (JR) 09/2019, veç të tjerash, është shprehur se: *“... trupi gjykues çmon se deklaratimet e subjekteve të rivlerësimit përfshijnë edhe persona, të cilët nuk janë në certifikatën familjare, kur pasuritë dhe burimi i krijimit të tyre afektojnë njëra-tjetrën në kohë të ndryshme dhe kalimet e pronësisë janë bërë ndërmjet familjarëve. Nuk detyrohet të deklarojë nga Komisioni për persona të cilët nuk janë në certifikatën familjare aktuale përveç atyre që parashikon ligji, por detyrimi vjen si pasojë e saktësisë së deklaratimit në transaksionet ku janë përfshirë edhe familjarët e tjerë”*.
30. Gjithashtu, trupi gjykues çmon të theksojë se në pikën 14, të nenit 3, të ligjit nr. 84/2016 parashikohet rrethi i personave të tjerë të lidhur, të cilët kanë ose kanë pasur lidhje interesi me subjektin e rivlerësimit, që rrjedh nga një interes pasuror ose çdo marrëdhënie tjetër biznesi.
31. Për sa më sipër, Komisioni e gjen të pabazuar pretendimin, për sa kohë si subjekti ashtu edhe motra, përgjatë periudhës së rivlerësimit, kanë banuar në një shtëpi, së bashku me prindërit dhe, për rrjedhojë, çdo anëtar ka kontribuar dhe përfituar nga bashkësia familjare, sipas rastit e mundësive, duke pasur interesa pasurore të përbashkëta mes tyre. Për rrjedhojë, lidhja dhe detyrimi i subjektit të rivlerësimit për të provuar burimin e ligjshëm të kësaj pasurie legjitimohet në mënyrë të dyfishtë, pra fillimisht dhe kryesisht: (i) për sa kohë motra është në certifikatën e përbashkët familjare; si dhe për faktin se (ii) kjo e fundit është bashkinvestitore me subjektin e rivlerësimit.
32. Ndryshe nga sa është konstatuar në rezultatet e hetimit, pas administrimit të dokumentacionit të paraqitur nga subjekti së bashku me shpjegimet e dhëna prej saj dhe pas përfshirjes në analizë të të ardhurave nga aktiviteti i vëllait, “E. G.” person fizik, për vitet 2010 dhe 2011, si dhe pagat e tij gjatë periudhës që ka banuar së bashku me familjen,

<sup>23</sup>Vendimi nr. (JR) 09/2019 i KPA-së.

të cilat arrijnë vlerën prej 1,420,120 lekësh, si dhe zbritjes së shpenzimeve të jetesës së familjes, duke i përllogaritur për 10 muaj të vitit 2011<sup>24</sup>, ka rezultuar se familja e subjektit ka pasur mjaftueshmëri financiare për blerjen e pasurisë në fjalë, me burime të ligjshme financiare, e cila paraqitet e detajuar në tabelën vijuese.

	Në rezultate	Pas prapësimeve
Të ardhura nga Magjistratura D. Goxha 2010 - tetor 2011	521 000	521 000
Të ardhura nga paga O. Goxha 2010 - tetor 2011	788 000	788 000
Të ardhura nga Universiteti Drejtësisë D. Goxha	-	-
Të ardhura të prindërve F. & Xh. Goxha	-	-
Të ardhura të vëllait E. Goxha 2010 - tetor 2011	-	1 420 120
Shpenzime jetese 2010 - tetor 2011	- 1 366 200	- 1 252 350
Shpenzim për blerje automjeti	- 980 000	- 980 000
<b>Rezultati</b>	<b>- 1 037 200</b>	<b>496 770</b>

### 3. Llogari rrjedhëse në vlerën 2,198 lekë, në “Raiffeisen Bank”

33. Subjekti ka deklaruar llogarinë rrjedhëse të pagës në “Raiffeisen Bank” periodikisht, duke filluar nga DIPP-ja e vitit 2012, si dhe në deklaratën *Vetting*, në të cilën ka rezultuar e pasqyruar shuma 2,197.9 lekë, me burim të ardhurat nga paga.
34. Në DIPP-në e vitit 2013, subjekti ka deklaruar *overdraft*<sup>25</sup> në “Raiffeisen Bank”, në shumën 70,000 lekë dhe në mbështetje të këtij deklarimi ka paraqitur kontratën e kredisë me kufi (*overdraft*) të nënshkruar në datën 19.12.2016, nga ku është evidentuar se shuma e akorduar nga banka ka qenë në vlerën 200,000 lekë. Gjithashtu, subjekti ka paraqitur vërtetimin nr. \*\*\* prot., datë 26.1.2017, nga banka, sipas të cilit gjendja e *overdraft*-it në datën 26.1.2017 ka qenë në vlerën 197,802.1 lekë.
35. Nga dokumentacioni i paraqitur nga “Raiffeisen Bank”<sup>26</sup> ka rezultuar se gjendja në llogarinë bankare të subjektit përputhet me atë të deklaruar prej saj në deklaratën *Vetting*, si dhe është konfirmuar burimi i krijimit të saj me të ardhurat nga paga e subjektit.

### 4. Gjendje *cash* në vlerën 600,000 lekë, si dhe kredi në vlerën 1,020,000 lekë

36. Në deklaratën *Vetting*, si dhe në DIPP-në e vitit 2016, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar gjendje *cash* jashtë sistemit bankar në vlerën 600,000 lekë, për të cilën ka deklaruar si burim krijimi kredinë konsumatore të marrë në “Raiffeisen Bank” dhe të deklaruar në të dyja deklaratat e sipërcituara në vlerën 1,020,000 lekë.
37. Në mbështetje të sa më sipër, subjekti ka paraqitur kontratën e kredisë të datës 12.7.2016, lidhur midis subjektit në cilësinë e kredimarrësit, “Raiffeisen Bank”, në cilësinë e kredidhënësit dhe znj. O. G. (motra e subjektit) në cilësinë e dorëzanësit, në të cilën është cituar se “Raiffeisen Bank” i ka akorduar subjektit të rivlerësimit shumën prej 1,020,000

<sup>24</sup>Sikundër subjekti ka pretenduar, për shkak të momentit që është bërë subjekt deklarues.

<sup>25</sup>Subjekti i rivlerësimit ka deklaruar për herë të parë në DIPP-në e vitit 2013, *overdraft* në “Raiffeisen Bank” në shumën 70,000 lekë, pa likuiduar shumën prej 58,400 lekësh. Si burim për likuidimin e pjesshëm të tij, subjekti ka deklaruar të ardhurat nga paga. Në DIPP-në e vitit 2015, subjekti ka deklaruar se ka ndryshuar marrëveshjen ekzistuese dhe nëpërmjet marrëveshjes së re, ka rritur limitin e huas në vlerën 120,000 lekë, shtesë mbi limitin e mbetur, për një afat 10-mujor, si dhe kështu për t'u paguar në vlerën 12,000 lekë.

<sup>26</sup>Me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 6.4.2021.

lekësh, për përdorim personal, me afat maturimi 60 muaj nga data e disbursimit<sup>27</sup>.

38. Në përgjigje të pyetësorit nr. 2, subjekti ka deklaruar se këtë kredi e ka marrë me qëllim për blerjen e një automjeti, si dhe për të përballuar shpenzimet e udhëtimit dhe ato personale, që do t'i nevojiteshin për të udhëtuar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Berat, në të cilën ushtronte detyrën në atë kohë<sup>28</sup>.
39. Nga analiza e llogarisë bankare të subjektit ka rezultuar se disbursimi i kredisë është kryer në datën 13.7.2016, në llogarinë rrjedhëse të saj në këtë bankë, dhe se subjekti ka tërhequr *cash* në datën 14.7.2016 shumën prej 1,000,000 lekësh nga shuma e akorduar. Sikurse është pasqyruar më sipër, subjekti ka deklaruar disponimin *cash* të shumës 600,000 lekë nga shuma e tërhequr. Në lidhje me diferencën e mbetur në vlerën prej 400,000 lekësh, në përgjigje të pyetësorit nr. 2<sup>29</sup>, subjekti ka deklaruar se këtë shumë e ka përdorur për të përballuar shpenzimet personale. Nga sa më sipër ka rezultuar se subjekti ka pasur burime të ligjshme financiare për krijimin e gjendjes së deklaruar *cash*.

## **5. Konstatime të tjera përgjatë procesit të rivlerësimit**

### **5.1. Lidhur me disa veprime/transferta bankare të kryera nga prindërit e subjektit**

40. Pasi është pyetur në lidhje me disa transaksione bankare të rezultuara përgjatë hetimit dhe të kryera nga prindërit e subjektit të rivlerësimit, në përgjigje të pyetësorit nr. 2, subjekti ka bërë me dije se ato kanë qenë veprime të kryera për llogari të aktiviteteve tregtare të babait dhe të vëllezërve të saj. Gjithashtu, subjekti ka sqaruar se vëllai i saj S. G., në datën 14.9.2009, ka themeluar shoqërinë tregtare “K. & T.” sh.p.k.<sup>30</sup> dhe furnitor i saj ka qenë shoqëria tregtare “I. L.” s.p.a. Me këtë shoqëri, kundrejt së cilës adresohen pjesa më e madhe e depozitimeve në fjalë, subjekti ka deklaruar se përveç vëllait, ka bashkëpunuar edhe babai i saj, përmes marrëveshjeve verbale nga viti 2005 deri në vitin 2010, nëpërmjet shoqërisë së tij tregtare “D.” sh.p.k.
41. Subjekti i rivlerësimit, në përgjigje të nevojave për hetim të kërkuar nga Komisioni, ndër të tjera, ka sqaruar se transfertat e kryera pranë “Veneto Bank” sh.a. kanë qenë për llogari të shoqërisë “K. & T.” sh.p.k. dhe se ato janë pagesa të kryera në favor të shoqërisë italiane “I. L.” s.p.a. dhe se llogaria është hapur në këtë bankë, me qëllim lehtësimin dhe shpejtimin e procedurave të blerjes së mallrave dhe reduktimin e kohës së transfertave bankare për furnizimin me mallra të kësaj shoqërie.
42. Nga analiza e historikut të lëvizjeve bankare në “Veneto Bank” sh.a. (sot “Intesa Sanpaolo Bank” sh.a.) ka rezultuar se depozitat e kryera në monedhat euro dhe lekë, si dhe

<sup>27</sup>Referuar kontratës së kredisë ka rezultuar se është marrë për një afat 60-mujor, me normë interesi 8.90 % në vit, kundrejt kështit mujor në vlerën 21,124.05 lekë.

<sup>28</sup>Gjithashtu, subjekti ka deklaruar se blerja e automjetit nuk është realizuar në kohën e marrjes së kredisë, pasi ka pritur deri në gjetjen e një automjeti të përshtatshëm për të.

<sup>29</sup>Në përgjigje të pyetësorit nr. 2, të dërguar nga Komisioni, subjekti ka shpjeguar se: “Në DIPP-në e vitit 2016 kam sqaruar se një nga qëllimet e marrjes së kësaj kredie ka qenë edhe për shpenzime transporti. Gjithashtu, kam vlerësuar se me rikthimin në Berat do më nevojiteshin më shumë mjete monetare për të mbuluar shpenzimet e nevojshme që mund të më lindnin për arsye personale, familjare, ushqime, veshje, pushime, kujdesi shëndetësor, duke qenë se shpenzimet e mia do të rriteshin. Megjithatë atë vit nuk gjeta ndonjë automjet të përshtatshëm për ta blerë, një pjesë të kredisë e përdora për shpenzimet e sipërcituara, ndërsa pjesën tjetër në shumën 600,000 lekë atë vit e kam ruajtur si kursim në eventualitet nëse do gjeja një automjet të përshtatshëm për ta blerë”.

<sup>30</sup>Me objekt veprimtarie: import-eksport, tregti me shumicë dhe pakicë të mallrave industriale, ushqimore, artikujve kozmetikë, artikujve blegtoralë.

konvertimet sipas rastit në monedhën euro janë transferuar në llogarinë bankare të shoqërisë “I. L.” s.p.a<sup>31</sup>, me përshkrimin “kalim në favor të ‘I. L.’ s.p.a. sipas marrëveshjes”.

43. Subjekti ka deklaruar si burim për kryerjen e depozitave në favor të furnitorit: (i) të ardhurat nga aktiviteti tregtar i shoqërisë “K. & T.” sh.p.k.; (ii) një kredi<sup>32</sup> të marrë në vitin 2013 nga kjo shoqëri në Bankën Kombëtare Tregtare sh. a. në shumën 3,000,000 lekë; dhe (iii) një kredi në Bankën Ndërkombëtare Tregtare sh. a., në të njëjtin vit, në shumën 10,000,000 lekë.
44. Lidhur me depozitimet e kryera prej babait të subjektit në BKT, në vitin 2016, Komisioni konstatoi nga dokumentacioni i paraqitur se këto derdhje ishin kryer në llogari të shoqërisë “E.” sh.p.k., aksioner i së cilës është vëllai i subjektit, z. E. G.. Konkretisht, veprimi i datës 24.8.2016, në shumën 820,000 lekë së bashku me disa depozitime të kryera nga vëllai i subjektit, janë konvertuar në euro. Po ashtu, shuma prej 1,200,000 lekësh, e depozituar prej babait të subjektit në datën 5.12.2016 ka rezultuar të jetë konvertuar në euro në favor të shoqërisë. Ndërsa shuma e depozituar në datën 28.12.2016, në shumën 830,000 lekë ka rezultuar se është përdorur prej shoqërisë për zhdoganim malli. Shuma prej 20,000 euro, e depozituar në llogarinë në euro të shoqërisë “E.” sh.p.k., prej babait të subjektit, duket të jetë transferuar më pas në llogari të një shoqërie “V.” s. a., për faturën nr. \*\*\*.
45. Nga analiza e lëvizjeve bankare të sipërpërshkruara ka rezultuar se depozitimet janë kryer me shënimin “punonjës”, krahas emrit të babait të subjektit. Ndonëse këto shuma monetare janë përdorur për nevoja të shoqërive përkatëse, përgjatë hetimit, subjekti nuk paraqiti ndonjë dokumentacion që të provojë qëllimin/destinacionin e tyre për llogari të shoqërisë “E.” sh.p.k., si dhe përdorimin e fondeve të shoqërisë, për të cilat Komisioni i ka kaluar subjektit barrën e provës.
46. Për sa i përket tërheqjes nga nëna të shumës 1,990,000 lekë nga BKT-ja sh. a., subjekti ka deklaruar si burim kontratën e kredisë bankare të datës 6.3.2015, të lidhur midis shtetasës Xh. G. dhe Bankës Kombëtare Tregtare sh. a.<sup>33</sup>, me objekt “lëvrimi i shumës 2,000,000 lekë”. Si garanci për këtë kredi është vendosur depozita e saj bankare në vlerën 2,200,000 lekë. Subjekti ka shpjeguar se kjo shumë është tërhequr nga nëna e saj dhe është përdorur për shoqërinë “E.” sh.p.k., në të cilën ka qenë e punësuar.
47. Në lidhje me shumën 1,000,000 lekë, të depozituar në “Union Bank” sh.a., në datën 8.4.2013, nga nëna, subjekti ka sqaruar se bëhet fjalë për një kontratë depozite me afat, e cila është mbyllur përpara afatit të maturimit. Kjo shumë është tërhequr në datën 15.10.2014, së bashku me interesat në vlerën totale prej 1,080,741 lekësh. Si burim për krijimin e saj, subjekti ka deklaruar: (i) kursimet personale të nënës; (ii) të ardhura nga aktiviteti tregtar ndër vite i shtetasit F. G., në të cilin nëna ka dhënë kontribut; (iii) të

<sup>31</sup>Subjekti ka deklaruar se për kryerjen e këtyre depozitave, babai ka qenë i pajisur me autorizim nga shoqëria “K. & T.” sh.p.k., por për shkak të kohës së gjatë që ka kaluar, si dhe faktit që shoqëria ka pezulluar aktivitetin në vitin 2015, ajo është në pamundësi objektive për të vënë në dispozicion kopje të autorizimit.

<sup>32</sup>Nga dokumentacioni i paraqitur prej subjektit, kredia e marrë në BKT në shumën 3,000,000 lekë është marrë në datën 16.5.2013 dhe është mbyllur në datën 6.8.2013. Ndërsa kredia e marrë në BNK është marrë me qëllim shlyerjen e balancës së mbetur të kredisë ekzistuese (*overdraft*) të marrë në BKT dhe diferenca për nevoja të shoqërisë.

<sup>33</sup>Komisioni i është drejtuar BKT-së me shkresat nr. \*\*\* prot., datë 12.3.2021 dhe nr. \*\*\* prot., datë 13.7.2021, për të cilat nga institucioni bankar ende nuk janë kthyer përgjigjet.

ardhura nga likuidimi i mallrave të shoqërisë “D.” sh.p.k., në vitin 2010; (iv) të ardhura nga aktiviteti i shoqërive “E.” sh.p.k. dhe “K. & T.” sh.p.k., si dhe çdo shumë tjetër që i është dhënë dhe është kursyer prej saj ndër vite. Subjekti ka shpjeguar se kjo depozitë është tërhequr dhe konsumuar, pra nuk ka ekzistuar në momentin e plotësimit të deklaratës *Vetting* dhe nuk ka paraqitur ndonjë dokumentacion mbi burimet e përmendura. Komisioni i ka kaluar subjektit të rivlerësimit barrën e provës për të paraqitur dokumentacionin mbi burimin e ligjshëm të të ardhurave që kanë mundësuar krijimin e depozitave bankare në fjalë.

48. Nga dokumentacioni i administruar<sup>34</sup> nga Komisioni përgjatë hetimit ka rezultuar se në llogari të babait të subjektit, F. G., janë transferuar shumat 39,999 euro në “Raiffeisen Bank” dhe 20,000 euro në “Intesa Sanpaolo Bank”, nga noter E. H., me përshkrimin “kontratë shitjeje me kusht e pasurisë së paluajtshme nr. \*\*\*, datë 9.12.2016”.
49. Në përgjigje të pyetësorit nr. 2, subjekti ka deklaruar se pasuria objekt i kontratës së sipërcituar, është blerë nga vëllai në vitin 2009, përpara se ajo të emërohej në detyrën e gjyqtarit dhe është përdorur vetëm prej tij dhe familjes së tij<sup>35</sup>. E pyetur në lidhje me marrëdhënien me blerësit e kësaj pasurie, shtetasit A. dhe A. V., subjekti ka deklaruar se nuk ka asnjë lloj marrëdhënie shoqërore/familjare apo të çfarëdolloj, nuk i njeh këta persona, nuk ka gjykuar ndonjëherë çështje ku ata kenë qenë palë<sup>36</sup> dhe nuk gjendet në kushtet e konfliktit të interesave me ta.

#### **Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit**

50. Subjekti ka bërë me dije se mes personave juridikë apo fizikë tregtarë të regjistruar, këta në emër të babait dhe/ose vëllezërve të saj, nuk ka pasur dhe nuk ka një marrëveshje në formë shkresore, por marrëveshje verbale për furnizim të vazhdueshëm mallrash, ku shoqëria “I. L.” s.p.a., sipas porosive që i janë bërë përmes telefonit, e-mailit apo aplikacioneve [www.migroweb.it](http://www.migroweb.it) dhe sipas *self-promo* [www.migroapp.com](http://www.migroapp.com) ka furnizuar me produkte personat juridikë, si dhe personin fizik “E. G.”. Pra, termi i përdorur në secilën transfertë “sipas marrëveshjes” nënkupton pagesën apo parapagesën e porosisë për produkte të ndryshme ushqimore apo industriale, porosi këto të bëra sipas njërës nga

---

<sup>34</sup>Nga dokumentacioni i administruar kanë rezultuar gjithashtu disa pagesa bankare/derdhje *cash*, nga nëna Xh. G., me vlerë 10,000 euro/secila, në favor të shoqërisë ndërtuese “E.” sh.p.k., me përshkrimin “pagesë për këst apartamenti sipas kontratës nr. \*\*\*, datë 13.5.2020”. E pyetur nga Komisioni në lidhje me transaksionet e përshkruara më sipër, në përgjigje të pyetësorit nr. 2, subjekti ka deklaruar se kontrata në fjalë është e lidhur midis shoqërisë “E.” sh.p.k. dhe shtetases Xh. M. G., e vitlindjes 1993, pra jo nga nëna e saj, por nga një shtetase tjetër. Subjekti ka paraqitur edhe kontratën.

<sup>35</sup>Sa i takon origjinën së pronës, subjekti ka shpjeguar se kjo pasuri e ka origjinën nga kontrata e sipërmarrjes e lidhur me shoqërisë “H. N.” sh.p.k. dhe vëllait të subjektit S. G. në datën 7.5.2009 dhe po në këtë kohë është bërë edhe pagesa e çmimit të blerjes. Kontrata e sipërmarrjes është bërë me akt të thjeshtë midis tyre. Ai ka disponuar deri vonë kopjen e kontratës së sipërmarrjes dhe mandatarkëtimin, por për shkak se atë pasuri nuk e ka më në pronësi që prej vitit 2016, nuk i disponon më këto dokumente, sepse ka menduar se nuk do t’i nevojiteshin, si dhe ka sqaruar se vëllai, prej tre vjetësh, nuk jeton më në Shqipëri. Në kohën që është realizuar kontrata në vitin 2009 pallati nuk ka qenë i regjistruar. Regjistrimi është kryer në vitin 2013 dhe certifikata për apartamentin e banimit të sipërcituar është lëshuar po në vitin 2013, në emër të shoqërisë “H. N.” sh.p.k., çka rezulton edhe nga kartela e pasurisë së paluajtshme. Më tej është formalizuar edhe kontrata e shitjes nr. \*\*\*, datë 24.12.2013, me qëllim regjistrimin e pasurisë në emër të vëllait. Pra, kjo kontratë nuk reflekton momentin e fitimit të pronësisë nga vëllai, i cili është bërë pronar i saj që në vitin 2009, çka konfirmohet edhe nga shoqëria “H. N.” sh.p.k., përmes deklaratës noteriale nr. \*\*\*, datë 22.7.2021. Çmimi për apartamentin në fjalë është paguar tërësisht në vitin e lidhjes së kontratës (2009) dhe kjo pasuri nuk ka qenë në pronësi të vëllait në momentin e plotësimit të deklaratës *Vetting* nga subjekti.

<sup>36</sup>Subjekti ka paraqitur vërtetimet për mungesën e konfliktit të interesit nga Gjykatat e Rretheve Gjyqësore: Tiranë nr. \*\*\* prot., datë 16.6.2021; Berat nr. \*\*\* prot., datë 21.7.2021; dhe Kavajë nr. \*\*\* prot., datë 21.7.2021.

format e sipërcituara dhe për të cilat është lëshuar fatura përkatëse nga furnizuesi “I. L.” s.p.a. Duke qenë veprime me karakter tregtar për blerje mallrash dhe jo investime, referuar edhe natyrës së aktivitetit tregtar të vëllait, duhet mbajtur në konsideratë se ka të bëjë me një qarkullim të vazhdueshëm mallrash dhe parash. Nuk janë transferta parash, por janë pagesa apo parapagesa për blerje mallrash, të cilat më pas janë shitur në tregun e brendshëm.

51. Gjithashtu, subjekti është shprehur se veprimet në fjalë të depozitimeve dhe transferimeve gjatë vitit 2013 janë kryer prej babait për llogari të shoqërisë “K. & T.” sh.p.k., mbi bazën e porosisë së djalit S. G.. Babai ka qenë i pajisur me autorizim nga shoqëria për të kryer veprimet e mësipërme, por për shkak të kohës së gjatë që ka kaluar, për shkak të faktit që kjo shoqëri tregtare e ka pezulluar aktivitetin që në vitin 2015, subjekti ka deklaruar se është në pamundësi objektive për të vënë në dispozicion kopje të autorizimit.
52. Lidhur me depozitimet dhe transfertat e kryera përgjatë vitit 2016 nga babai i subjektit të rivlerësimit në llogari të shoqërisë “E.” sh.p.k., subjekti është shprehur se veprimet në llogari të shoqërive “I. L.” s.p.a., “V.” s.a. dhe “M. G.” s.p.a., për llogari të shoqërisë “E.” sh.p.k., në asnjë rrethanë faktike e ligjore nuk lidhen me të apo me të ardhurat e babait dhe nuk ndikojnë në vlerësimin e kriterit të pasurisë. Edhe sikur ky fakt të merrej i mirëqenë, ato nuk e kanë burimin nga ekonomia familjare dhe as nuk janë bërë pjesë e saj. Ashtu sikurse është konstatuar edhe nga Komisioni, këto veprime janë kryer nga babai për llogari të aktivitetit tregtar të vëllait të subjektit E. G., nëpërmjet një autorizimi për kryerjen e veprimeve pranë bankave të nivelit të dytë.
53. Për të provuar faktin se babai i subjektit ka vepruar si përfaqësues dhe mbi bazën e një autorizimi nga këto shoqëri duke kryer veprime të ndryshme me vlera financiare për llogari të tyre, subjekti ka paraqitur në cilësinë e provës aktet si vijon:
  - a. pasqyrat financiare të shoqërisë “K. & T.” sh.p.k. për vitet 2010, 2011, 2012 dhe 2013;
  - b. vendimin e ortakut të shoqërisë “K. & T.” sh.p.k. për caktimin e likuidatorit;
  - c. pasqyrat financiare të shoqërisë “E.” sh.p.k. për vitet 2014, 2015 dhe 2016;
  - d. fatura të lëshuara nga shoqëria “I. L.” s.p.a. dhe deklarata doganore për shoqërinë “K. & T.” sh.p.k.;
  - e. faturën e vitit 2016, lëshuar nga shoqëritë “V.” s.p.a., “G.” S.p.a. dhe deklaratën doganore;
  - f. autorizimin e lëshuar nga shoqëria “E.” sh.p.k. për z. F. G.;
  - g. vërtetimin nga BKT-ja dhe historikun e lëvizjeve bankare në këtë bankë.
54. Lidhur me depozitën bankare në emër të nënës, në vitin 2013, në “Union Bank” sh.a., në vlerën 1,000,000 lekë, subjekti ka sqaruar se likuiditetet kanë qenë në pronësi dhe administrim të saj dhe janë krijuar në maj 2011, dhjetor 2011 si dhe maj 2012, përpara se subjekti të fillonte stazhin profesional si gjyqtare stazhiere në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë<sup>37</sup>.

<sup>37</sup>Subjekti ka pretenduar se për sa kohë kjo depozitë është tërhequr dhe nuk ka ekzistuar në momentin e dorëzimit të deklaratës *Vetting*, subjekti nuk duhet të ngarkohet me barrë prove për të, duke referuar për analogji vendimin nr. 12/2019 të Kolegjit të Posaçëm të Apelit, në të cilin citohet se: “... objekt i vlerësimit të pasurisë nga ana e Komisionit është deklarimi i pasurive

55. Lidhur me burimin e krijimit të depozitës së përshkruar më sipër, subjekti i ka qëndruar të njëjtave shpjegime të dhëna edhe në përgjigje të pyetësorit nr. 2, në të cilin ka sqaruar se: *“[ ]... këto depozita kanë si burim krijimi kursimet e saj personale (evenimente familjare në vite) të ardhurat në vite të babait tim, të ardhura nga familja e saj e origjinës, si dhe çdo shumë tjetër që i është dhënë asaj në vite dhe ajo e ka kursyer...[ ]”*.
56. Subjekti ka pretenduar përfshirjen në analizë të një shume prej 22,000 euro, të tërhequr nga babai në “Tirana Bank”, në vitin 2006. Gjithashtu, ka pretenduar se babai i saj në vitin 2010 ka pasur gjendje mallra në magazinë në vlerën 4,301,357 lekë dhe gjendje në arkë dhe në bankë shumën monetare në vlerën 872,759 lekë. Po ashtu, subjekti ka pretenduar se përderisa shpenzimet për pagën e personelit për vitet 2008 dhe 2009 qenë në vlerën 960,000 lekë për secilin vit, babai ka pasur mjaftueshmëri financiare për të përballuar shpenzimet e jetesës të përllogaritura për familjen e subjektit në vlerën 683,100 lekë për vitet 2008 dhe 2009, si edhe mundësinë për të kursyer diferencën e mbetur.
57. Gjithashtu, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur në cilësinë e provës dokumentacionin si vijojnë:
- deklaratën noteriale të datës 13.9.2021, nga z. E. G., ku deklaroi se të gjitha fitimet e realizuara dhe një pjesë nga pagat e tij si administrator i shoqërisë “E.” sh.p.k., ia ka dhënë prindërve të tij, për t’i ndihmuar dhe një pjesë për t’i kursyer;
  - deklaratë noteriale e datës 13.9.2021, në të cilën znj. Xh. G. ka deklaruar se ka marrë në mars të vitit 2015 kredi në shumën 2,000,000 lekë për t’ia dhënë djalit të saj, si dhe ka deklaruar se djali e ka ndihmuar financiarisht. Gjithashtu, nëna e subjektit ka deklaruar se në vitin 2013 ka çelur një depozitë, në të cilën ka kursyer të ardhurat e dhëna vazhdimisht prej tij;
  - ekstrakt llogarie bankare në “Tirana Bank” sh.a. për shtetasin F. G.;
  - historik i veprimeve të shoqërisë “D.” sh.p.k., në “Raiffeisen Bank” sh.a.;
  - pasqyrat financiare për periudhën 2007 – 2009, të shoqërisë “D.” sh.p.k.;
  - pasqyrat financiare të shoqërisë “K. & T.” sh.p.k. për periudhën 2010 – 2013;
  - vërtetim nr. \*\*\* prot., datë 27.8.2021, nga ISSH-ja për z. E. G. për periudhën 2010 - 2011;
  - vërtetim nr. \*\*\* prot., datë 26.8.2021, nga ISSH-ja për z. E. G. për periudhën 2012 – 2021.

### **Vlerësimi i trupit gjykues**

58. Trupi gjykues ka shqyrtuar dhe analizuar të ndërthurura dhe në harmoni me njëra-tjetrën të dhënat e disponuara dhe të administruara lidhur me gjendjet dhe lëvizjet bankare të lartpërmendura, duke konstatuar se pas njoftimit të rezultateve të hetimit, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur disa fatura të lëshuara nga shoqëria italiane “I. L.” s.p.a. për shoqërinë “K. & T.” sh.p.k. për shitje të mallrave të ndryshme, si dhe disa deklarata zhdoganimi për mallrat e importuara nga Italia, nga të cilat rezultoi se shoqëria “K. & T.” sh.p.k. ka blerë një sasi artikujsh në vlerën në vlerën 110,000 euro përgjatë viteve 2012 dhe 2013. Ndërkohë që shuma e depozituar në llogari të kësaj shoqërie ka qenë rreth

---

*të subjektit të rivlerësimit në momentin e deklaratës Vetting (ex nunc). Gjithashtu dhe deklaratimet periodike vjetore mund të merren në konsideratë si prova pasi ato mund të hedhin dritë mbi burimet e krijimit të pasurisë...”*



309,000 euro, por që shpjegohet nga subjekti se me furnitorin babai dhe vëllezërit kanë pasur një marrëveshje verbale dhe, në disa raste, janë kryer disa parapagime. Ndërsa, për sa i përket burimit të ligjshëm të të ardhurave që kanë mundësuar kryerjen e depozitës në fjalë, nga analiza e pasqyrave financiare të shoqërisë “K. & T.” sh.p.k., të viteve 2012 dhe 2013 ka rezultuar se shoqëria ka pasur fonde të disponueshme në shumën 49,493,428 lekë (~ 353,000 euro), e cila ka qenë e mjaftueshme për të mbuluar shumat e depozituara dhe transferuara gjatë vitit 2013, në vlerën 309,000 euro.

59. Në lidhje me depozitën prej 830,000 lekësh, të kryer nga babai i subjektit të rivlerësimit në datën 28.12.2016, përmes BKT-së, subjekti ka paraqitur faturat e lëshuara nga shoqëria “G.” s.p.a, për të provuar që kjo depozitë është përdorur prej shoqërisë “E.” sh.p.k. për pagesën e tarifës doganore, sipas deklaratës së zhdoganimit të së njëjtës datë.
60. Në lidhje me depozitën e datës 5.12.2016, në vlerën 1,200,000 lekë, të kryer nga babai i subjektit, nga analiza e lëvizjeve në BKT ka rezultuar se kjo shumë është konvertuar në monedhën euro dhe është tërhequr nga administratori dhe ortaku i vetëm i shoqërisë, z. E. G.. Ndërsa, shuma prej 20,000 euro, e depozituar në llogarinë në euro të shoqërisë “E.” sh.p.k., nga babai i subjektit, ka rezultuar e transferuar më pas në llogari të shoqërisë “V.” s.p.a. për likuidimin e faturës me nr. \*\*\*.
61. Në lidhje me burimin e ligjshëm të shumave të depozitimeve të sipërcituara, nga dokumentacioni i administruar nga BKT-ja ka rezultuar se ato janë kryer me përshkrimin “të ardhurat nga biznesi”. Komisioni ka hetuar mbi mjaftueshmërinë financiare të aktivitetit tregtar të shoqërisë “E.” sh.p.k., duke marrë në analizë pasqyrën financiare të kësaj shoqërie për vitin 2016, nga e cila ka rezultuar se qarkullimi i vlerave monetare të shoqërisë ka qenë në shumën 33,655,008 lekë, çka provon mjaftueshmërinë financiare për kryerjen e depozitave të përshkruara më sipër.
62. Lidhur me dokumentacionin e paraqitur nga subjekti, Komisioni vlerëson se ato provojnë faktin se: (i) shoqëria “K. & T.” Sh.p.k. dhe shoqëria “E.” Sh.p.k., ka qenë në marrëdhënie tregtare me shoqërinë “I. L.” s.p.a., si dhe ka kryer transferta të konsiderueshme me këtë shoqëri; (ii) shtetasi F. G. ka vepruar si përfaqësues i interesit tregtar të shoqërisë tregtare të djalit të tij, pasi në depozitat e kryera identifikohet llogaria bankare pritëse/përfituese dhe qëllimi i saj. Sa më sipër, këto prova janë të mjaftueshme në vlerësimin e Komisionit për të konsideruar pretendimin e subjektit se veprimet e sipërpërshkruara janë kryer për llogari të këtyre shoqërive tregtare.
63. Në lidhje me depozitën bankare të nënës së subjektit në BKT, nga dokumentacioni i paraqitur nga subjekti, si dhe ai i përcjellë nga kjo bankë, pas mbylljes së rezultateve të hetimit, ka rezultuar se investimi është kryer fillimisht në shumën 1,500,000 lekë në vitin 2011 dhe 700,000 lekë në maj të vitit 2012, pra përpara fillimit të detyrës së subjektit.
64. Lidhur me pretendimin e subjektit për përfshirjen në analizë të shumës 22,000 euro, të tërhequr nga babai i saj, nga llogaria e tij në “Tirana Bank”, në vitin 2006, ka rezultuar se shuma e sipërcituar është depozituar dhe është tërhequr prej tij, të nesërmen. Ndërkohë, nga subjekti nuk është paraqitur ndonjë dokumentacion ligjor, nëpërmjet të cilit do të mund të provohej burimi i ligjshëm i depozitimit të saj dhe as destinacioni i saj. Për rrjedhojë, pretendimi i subjektit mbetet në nivel deklarativ.

65. Lidhur me aktivitetin e babait dhe ato të vëllezërve të subjektit dhe shumave të mundshme të tërhequra prej llogarive të shoqërive të tyre, e të përdorura më pas për nevoja të familjes, sikurse është arsyetuar më parë në këtë vendim, përveç personit fizik “E. G.”, nga dokumentacioni i paraqitur pas mbylljes së hetimeve nga DPT-ja ka rezultuar se nuk është paguar dividend nga shoqëritë “D.” sh.p.k., “K. & T.” sh.p.k. dhe “E.” sh.p.k.
66. Në këtë këndvështrim, trupi gjykues çmon se të ardhurat e realizuara nga aktivitetet tregtare të familjarëve të subjektit, për të cilat subjekti ka kërkuar të përfshihen në analizën financiare, nuk mund të konsiderohen si të ardhura me burime të ligjshme, për sa kohë nuk është provuar me dokumentacion zyrtar ligjshmëria e tyre, jo vetëm për sa i takon gjenerimit të tyre, por edhe pagesës së detyrimeve tatimore. Ky qëndrim bazohet në kërkesat kushtetuese dhe ligjore lidhur me të provuarin bindshëm të vlerës së të ardhurave me dokumentacion dhe ligjshmërisë së tyre në kuptim të pikës 3, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës dhe të neneve 32, pikave 1 dhe 2; 49, pikat 4 dhe 3, pika 19 e ligjit nr. 84/2016, dispozita këto që disponojnë sa vijon.
67. Pika 3, e nenit D, të Aneksit të Kushtetutës parashikon se: *“[...] Subjekti i rivlerësimit duhet të shpjegojë bindshëm burimin e ligjshëm të pasurive dhe të të ardhurave. Pasuri të ligjshme për qëllimet e këtij ligji konsiderohen të ardhurat që janë deklaruar dhe për të cilat janë paguar detyrimet tatimore. Elemente të tjera të pasurisë së ligjshme përcaktohen me ligj [...]”*.
68. Pikat 1 dhe 2, të nenit 32, të ligjit nr. 84/2016 përcaktojnë se: *“[...] 1. Subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të, së bashku me deklaratën e pasurisë, paraqesin të gjitha dokumentet që justifikojnë vërtetësinë e deklarimeve për ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurive. 2. Nëse subjekti i rivlerësimit është në pamundësi objektive për të disponuar dokumentin që justifikon ligjshmërinë e krijimit të pasurive, duhet t’i vërtetojë institucionit të rivlerësimit se dokumenti është zhdukur, ka humbur, nuk mund të bëhet përsëri ose nuk merret në rrugë tjetër. Institucionet e rivlerësimit vendosin nëse mosparaqitja e dokumenteve justifikuese është për shkaqe të arsyeshme. Ky rregull zbatohet edhe në ato raste kur organi përgjegjës për lëshimin e dokumenteve justifikuese nuk përgjigjet brenda afatit ligjor [...]”*.
69. Pika 4, e nenit 49, të ligjit nr. 84/2016 parashikon se: *“[...] 4. Komisioni dhe Kolegji i Apelit e bazojnë vendimin e tyre vetëm në dokumentet nga burime të njohura, në prova të besueshme ose që janë në pajtueshmëri të dukshme me provat e tjera. Ata kanë të drejtë të çmojnë, sipas bindjes së tyre të brendshme, çdo indicie në tërësi lidhur me rrethanat e çështjes [...]”*.
70. Pika 19, e nenit 3, e ligjit nr. 84/2016 përcakton se: *“Të ardhura të ligjshme janë të ardhurat e subjektit të rivlerësimit dhe personave të lidhur të tij/saj, sipas përcaktimeve të burimit të të ardhurave, të parashikuara në ligjin ‘Mbi tatimin mbi të ardhurat’ [...]”*.
71. Gjithashtu, vlerësimi i trupit gjykues, veç mbajtjes në vëmendje të sa më sipër, ka konsideruar edhe jurisprudencën, tashmë të konsoliduar, të Kolegjit të Posaçëm të Apelit, lidhur me burimet e të ardhurave që duhet të quhen të ligjshme dhe mund të

përfshihen në përlllogaritjen e të ardhurave të subjektit të rivlerësimit dhe të personit të lidhur me të<sup>38</sup>.

72. Në përmbledhje të sa më sipër, Komisioni vlerëson se një pjesë e të ardhurave të pretenduara nga subjekti i rivlerësimit nga aktiviteti i babait dhe vëllait të saj, nuk e kalojnë testin e provueshmërisë si më lart dhe, për pasojë, as testin e ligjshmërisë së tyre. Për rrjedhojë, pretendimet e subjektit të rivlerësimit për përfitimin e këtyre të ardhurave të shoqërive tregtare të familjarëve të saj, mbeten pjesërisht në nivel deklarativ, ndonëse është provuar qarkullim i mjeteve monetare (në hyrje dhe dalje), në nivel të konsiderueshëm.
73. Konkretisht, lidhur me pretendimin e subjektit se në vitin 2010 shoqëria “D.” sh.p.k. ka marrë likuidimet e klientëve në vlerën 9,900,000 dhe ka shlyer furnitorët në shumën 7,600,000 lekë, ndërsa diferencën prej 2,300,000 lekësh administratori/babai i subjektit e ka disponuar personalisht (si individ) nga shqyrtimi i pasqyrave financiare të kësaj shoqërie dhe ka rezultuar se përveç detyrimeve ndaj furnitorëve, shoqëria ka pasur edhe detyrime ndaj punonjësve, detyrime tatimore dhe hua. Shuma totale e detyrimeve ka qenë në vlerën 10,300,000 lekë, ndërkohë që shuma për t’u arkëtuar ka qenë në vlerën 9,900,000 lekë. Megjithatë, për sa kohë shoqëria ka qenë në një administrim të zakonshëm, subjekti nuk ka pasur detyrimin për zbatimin e ndonjë radhe të caktuar për shlyerjen e detyrimeve. Nga ana tjetër, subjekti nuk ka paraqitur ndonjë dokumentacion ligjor të shoqërisë “D.” sh.p.k. në mbështetje të deklarimit të saj për arkëtimin e detyrimeve nga klientët brenda vitit 2010 dhe të përfitimit të shumës në fjalë prej administratorit/babait të saj. Në këto kushte, pretendimi i mësipërm lidhur me burimin e ligjshëm të këtyre të ardhurave mbetet në nivel deklarativ dhe nuk përmbush kërkesat e nenit D të Aneksit të Kushtetutës.
74. Në lidhje me pretendimin e subjektit mbi të ardhurat e realizuara nga babai i saj, nga shitja e mallrave në magazinë të mbetura në fund të vitit 2009, ndonëse shoqëria nuk ka depozituar bilanc për vitin 2010, Drejtoria Tatimore ka bërë me dije se gjatë këtij viti kjo shoqëri ka deklaruar qarkullim në masën 596,745 lekë dhe humbje në masën 718 lekë, për rrjedhojë, pretendimi i shitjes së mallrave gjendjet i pabazuar, për sa kohë nuk është pasqyruar në bilancin përkatës. Në këto kushte, trupi gjykues – nisur nga analiza e dokumenteve të administruara dhe duke mbajtur në vëmendje legjislacionin tatimor në fuqi, në periudhën përkatëse – në shqyrtim të pretendimeve të subjektit, çmon se vlera e gjendjes mall, të mbetur sipas inventarit, nuk mund të përkthehet automatikisht dhe të konsiderohet si një fitim *neto*, i realizuar në momentin e kalimit të aktivitetit në fjalë në statusin pasiv, sikurse pretendohet, për sa kohë nuk plotësohen kushtet e diktuar nga dispozitat ligjore të lartpërmendura. Si rrjedhojë, ligjshmëria e burimit financiar të pretenduar mbetet e paprovuar, për sa kohë subjekti i rivlerësimit nuk paraqiti asnjë dokument që të provonte së paku kryerjen e ndonjë transaksioni financiar nga shoqëria *de qua* me shuma që mund të përputheshin me vlerën dhe me periudhën e pretenduar.
75. Lidhur me pagat e babait të subjektit si administrator i shoqërisë “D.” sh.p.k. për vitet 2008 dhe 2009, të pretenduara në masën 960,000 lekë për secilin vit, edhe ky pretendim mbetet në nivel deklarativ për sa kohë nuk është paraqitur ndonjë dokumentacion që të provojë që

---

<sup>38</sup>Shihni vendimet e Kolegjtit: nr. 6/2019 (JR), datë 28.2.2019 dhe nr. 21/2019 (JR), datë 24.4.2019.

z. F. G. ka qenë i vetmi punonjës në shoqëri dhe që e gjithë shuma e shpenzimit të deklaruar në atë zë i përket atij. Për më tepër, nga dokumentacioni i paraqitur prej subjektit në përgjigjet e pyetësorit nr. 2, për të ardhurat e realizuara nga z. F. G., mbi bazën e të cilave është derdhur kontributi nga shoqëria “D.” sh.p.k., ka rezultuar se përveç 2 muajve të vitit 2008 (janar dhe mars), në shumën totale *bruto* 131,400 lekë, nuk kanë rezultuar të ardhura të tjera në formën e pagës.

76. Nisur nga sa më sipër është përllëgaritur mundësia për depozitim të shumës totale prej 2,200,000 lekësh, në depozitë me afat gjatë viteve 2011 dhe 2012, nga nëna e subjektit të rivlerësimit, duke përfshirë në analizë të ardhura të subjektit, të motrës dhe të vëllait<sup>39</sup> për periudhën 2010 – maj 2012, e cila paraqitet e detajuar në tabelën vijuese.

Të ardhura nga Magjistratura D. Goxha nentor 2011 - maj 2012	283 000
Të ardhura nga paga O. Goxha nentor 2011 - maj 2012	10 000
Të ardhura nga Universiteti Drejtësisë D. Goxha	68 650
Të ardhura të prindërve F. & Xh. Goxha	-
Të ardhura të vëllait E. Goxha nentor 2011 - maj 2012	509 581
Të mbetura pas blerjes së automjetit	496 770
Shpenzime jetese nentor 2011 - maj 2012	- 348 890
Investim në depozitë me afat	- 2 200 000
<b>Rezultati</b>	<b>- 1 180 889</b>

77. Trupi gjykues çmon se, ndonëse ka rezultuar kjo pamjaftueshmëri e burimeve të ligjshme financiare, në kuptim të nenit D të Aneksit të Kushtetutës - nga tërësia e provave dhe pretendimeve të subjektit të rivlerësimit është konstatuar një disponibilitet financiar *de facto* për të mundësuar krijimin e depozitës në fjalë. Gjithsesi, nisur nga harku kohor i kryerjes së këtij investimi përpara fillimit të detyrës nga subjekti i rivlerësimit, trupi gjykues vlerëson se kjo pamjaftueshmëri – për sa kohë: (i) nuk është përdorur dhe nuk lidhet me ndonjë pasuri apo shërbim që mund të ketë përfituar subjekti i rivlerësimit, asokohe apo më pas; dhe (ii) i referohet një periudhe kohore më të hershme se subjekti i rivlerësimit të emërohej në detyrën e gjyqtarit – nuk mund ta ngarkojë atë me përgjegjësi.
78. Lidhur me burimin e krijimit të shumës 1,000,000 lekë, të depozituar nga nëna e subjektit në “Union Bank”, në datën 8.4.2013, Komisioni ka përllëgaritur të ardhurat e familjes së subjektit për periudhën maj 2012 – prill 2013, nga ku ka rezultuar një mungesë e burimeve të ligjshme financiare prej 378,294 lekësh, e cila paraqitet e detajuar në tabelën në vijim:

<sup>39</sup>Për vitet 2010 dhe 2011 janë përfshirë fitimet nga personi fizik dhe nga paga e tij. Duke filluar nga viti 2012, z. Goxha është shkëputur nga familja dhe nuk ka banuar më në të njëjtën shtëpi dhe, për rrjedhojë, Komisioni ka njohur si kontribut në familje maksimumi fitimet e tij si person fizik, referuar deklaratës noteriale të paraqitur me prapësimet.

Të ardhura nga Magjistratura D. Goxha maj 2012 - prill 2013	609 200
Të ardhura nga paga O. Goxha maj 2012 - prill 2013	96 220
Të ardhura të prindërve F. & Xh. Goxha	-
Të ardhura të vëllait E. Goxha maj 2012 - prill 2013	799 176
Shpenzime jetese maj 2012 - prill 2013	- 517 088
Shpenzime të tjera	- 365 802
Investim në depozitë me afat	- 1 000 000
<b>Rezultati</b>	<b>- 378 294</b>

79. Për sa më sipër, trupi gjykues arrin në përfundimin se ky rezultat, nisur nga: (i) masa minimale e kësaj pamjaftueshmërie të mjeteve monetare në vitin 2013; dhe (ii) fakti që subjekti është emëruar si gjyqtare vetëm në vitin 2014; (iii) në çdo rast asnjë nga këto shuma, të qarkulluara nga prindërit, nuk është përdorur nga subjekti apo për investime familjare të përbashkëta me subjektin, nuk mund të përbëjë shkak për përgjegjësi disiplinore të subjektit të rivlerësimit.

## 5.2 Lidhur me dy hua të marra nga babai i subjektit, z. F. G.

80. Përgjatë hetimit administrativ ka rezultuar se nga babai i subjektit janë nënshkruar deklaratat noteriale në vijim:

- deklaratë noteriale nr. \*\*\*, datë 26.11.2015, sipas së cilës babai i subjektit ka marrë hua shumën prej 40,000 euro nga shtetasi A. L., shumë të cilën duhet ta kthejë brenda 1 viti;
- deklaratë noteriale nr. \*\*\*, datë 3.2.2017, babai i subjektit i ka njohur detyrimin në shumën prej 4,160,000 lekësh shtetasit B. H. në prani të noterës, shumë të cilën ia ka kthyer përsëri këtij shtetasi<sup>40</sup>.

81. Subjekti i rivlerësimit, në përgjigje të pyetësorit nr. 2, ka bërë me dije se shuma e huas nga babai është marrë me qëllim dhënien e ndihmës për të birin, shtetasin E. G. për veprimtarinë e tij tregtare për shoqërinë “E.” sh.p.k. Pasi vëllai E. G. i ka kthyer shumat në fjalë babait, ky i fundit ua ka kthyer ato personave të sipërcituar.

82. Lidhur me burimin e ligjshëm të të ardhurave të këtyre shtetasve, subjekti ka sqaruar se këto shuma nuk kanë shërbyer si kursim, investim apo burim për krijimin e pasurive të saj dhe as të prindërve apo të motrës, por janë përdorur si qarkullim financiar për biznesin e vëllait dhe u janë kthyer përsëri personave në fjalë dhe, për rrjedhojë, nuk duhet të trajtohen si persona të lidhur apo të tjerë të lidhur me subjektin e rivlerësimit.

83. Nga shpjegimet e dhëna nga subjekti dhe dokumentacioni i paraqitur ka rezultuar se shtetasi B. H. ka pasur dy depozita me afat përkatësisht të datave 20.6.2013 dhe 29.6.2016 në Bankën Amerikane të Investimeve sh.a., në shumat 1.300.000 lekë dhe 1.400.000 lekë. Në datën 21.9.2016 është tërhequr prej tij shuma 2,700,800 lekë. Gjithashtu, bashkëshortja e tij ka pasur pranë Bankës Amerikane të Investimeve sh.a., depozitën me afat në shumën 500,000 lekë, shumë të cilën e ka tërhequr më 21.9.2016. Po ashtu, ky shtetas në datën 26.9.2016 ka tërhequr shumën prej 53.100 lekësh. Pjesën tjetër e ka pasur *cash* në banesë.

<sup>40</sup>Deklarata noteriale për likuidim detyrimi nr. \*\*\*, datë 13.12.2018, në prani të noterës D. Ç..

84. Ndonëse dokumentacioni i paraqitur prej subjektit mund të provojë disponibilitetin e pjesëshëm të fondeve për dhënien e huas, nuk është provuar me dokumentacion ligjor momenti i dhënies së huas në shumën 4,160,000 lekë, mënyra e dhënies, qëllimi dhe destinacioni i përdorimit të saj për shoqërinë e vëllait të subjektit "E." sh.p.k. Gjithashtu, nuk ka rezultuar i provuar burimi i ligjshëm i huadhënësit për dhënien e shumës 4,160,000 lekë, si dhe burimi i ligjshëm i babait të subjektit për kthimin pas të shumës së mësipërme.
85. Gjithashtu, subjekti ka sqaruar se shtetasi A. L. ka pasur në llogarinë e tij në euro në Bankën Kombëtare Tregtare sh.a., shumën prej 49,748 euro të cilën e ka tërhequr. Por nga dokumentacioni i paraqitur, ka rezultuar se shuma 49,748 euro është riinvestuar në depozitë dhe nuk është tërhequr prej tij.
86. Për sa më sipër, Komisioni i ka kaluar subjektit barrën e provës për të provuar burimin e ligjshëm të të ardhurave të huadhënësve, që kanë mundur dhënien e huave në fjalë.

#### **Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit**

87. Subjekti ka deklaruar se me huadhënësit e sipërcituar nuk ka pasur asnjë lloj marrëdhënie shoqërore, personale/familjare apo të çfarëdolloji, pasi nuk i njeh personalisht këta persona dhe se gjendet në mungesë të konfliktit të interesit me ta, pasi nuk ka gjykuar ndonjëherë çështje ku ata kenë qenë palë. Për të provuar këtë rrethanë, subjekti ka paraqitur shkresën nr. \*\*\* prot., datë 21.7.2021, nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Berat, në të cilën konfirmohet se gjatë periudhës së ushtrimit të detyrës pranë kësaj gjykate, nuk është gjykuar prej subjektit ndonjë çështje me palë shtetasit e sipërpërmendur.
88. Në lidhje me burimin e ligjshëm të të ardhurave të huadhënësve, të përdorura për dhënien e huave respektive në shumat 40,000 euro dhe 4,160,000 lekë, në favor të babait të saj, si dhe qëllimin e përdorimit të tyre, subjekti ka deklaruar se ato nuk kanë shërbyer si burim për krijimin e ndonjë pasurie për subjektin apo për prindërit dhe motrën e saj, por janë përdorur për nevoja të shoqërisë tregtare të vëllait të saj. Gjithashtu, subjekti ka referuar për analogji vendimin nr. 18, datë 26.7.2019, të KPA-së, duke argumentuar se për sa kohë, nuk ka qenë e përfshirë as në mënyrë të drejtpërdrejtë e as të tërthortë në marrëdhëniet e huas së babait të saj me të tretët, nuk duhet të ngarkohet me barrë prove për të provuar burimet e ligjshme të tyre.
89. Gjithsesi, në lidhje me huan në vlerën 40,000 USD, subjekti ka bërë me dije se një pjesë e kësaj shume është shlyer në vitin 2017 dhe pjesa tjetër në vitin 2020, pra jo brenda vitit sikurse ishte dakordësuar në marrëveshjen mes palëve dhe konsideruar më herët nga Komisioni në analizën financiare dhe se si burim për kthimin - shlyerjen në fjalë, kanë shërbyer të ardhurat e realizuara nga aktiviteti tregtar i vëllait të saj.
90. Ndërsa, në lidhje me huan në shumën 4,160,000 lekë, subjekti ka deklaruar si burim të ardhurat e huadhënësit dhe bashkëshortes së tij, të ardhurat nga emigracioni i djemve të tyre, si dhe të ardhurat e realizuara nga shitja e një pasurie që dispononin në qytetin e Fierit. Gjithashtu, subjekti ka paraqitur një dokument të datës 15.1.2018, ku evidentohet çelja e një depozite me afat në vlerën 4,000,000 lekë, nga huadhënësi, nëpërmjet të cilit subjekti pretendon se ky veprim provon kthimin e kësaj shume nga babai i saj, ndaj huadhënësit.
91. Subjekti ka paraqitur në cilësinë e provës dokumentet e përshkruara në vijim:

- a. deklaratë noteriale e datës 31.7.2021, e shtetasit A. L., për mënyrën dhe kohën e shlyerjes së huas prej 40,000 euro nga babai i subjektit;
- b. kontratë shitblerjeje e datës 6.4.2011, e shitësit A. L., me çmimin 9,186,757 lekë;
- c. lëvizjet e llogarisë së shtetasit A. L. për depozitimin e shumës prej 90,000 euro, në datën 8.4.2011, me përshkrimin “derdhje nga kontrata shitblerjes” dhe, më pas, tërheqjen e shumës prej 50,000 euro në vitin 2014;
- d. çelje të një depozite bankare në emër të shtetasit B. H., në datën 15.1.2018, në shumën 4,000,000 lekë;
- e. deklaratë noteriale e datës 13.9.2021, e babait të subjektit, i cili ka deklaruar marrjen dhe kthimin e shumave të mësipërme, si dhe dhënien e këtyre shumave djalit të tij E. G. për biznesin e tij;
- f. deklaratë noteriale e datës 13.9.2021, në të cilën vëllai i subjektit ka deklaruar se është ndihmuar nga prindërit me mjete monetare dhe se i ka kthyer babait të tij, çdo shumë të marrë hua nga persona të tretë për të.

### **Vlerësimi i trupit gjykues**

92. Lidhur me pretendimin e subjektit se nuk duhet të ngarkohet me barrë prove për të provuar burimet e ligjshme të huadhënësve që kanë hyrë në marrëdhënie huaje me babain e saj, trupi gjykues çmon se referuar pikës 13 të nenit 3 dhe pikës 1, të nenit 32, të ligjit nr. 84/2016, prindërit e subjektit të rivlerësimit kualifikohen si persona të lidhur për sa kohë kanë qenë në trung të përbashkët familjar me subjektin. Në këtë këndvështrim subjekti duhet të provojë burimin e ligjshëm të huave të marra nga babai, brenda periudhës së rivlerësimit, për sa kohë ai ka qenë në një certifikatë familjare me subjektin.
93. Në lidhje me huan në vlerën 40,000 euro, sa i përket burimit të krijimit të të ardhurave të huadhënësit, subjekti ka paraqitur dokumentacionin për shitjen e pasurisë së shtetasit A. L., me kontratën e shitjes nr. \*\*\*, datë 6.4.2011, si dhe lëvizjet e llogarisë së tij bankare që provojnë faktin se që prej vitit 2011 ka pasur shumën 90,000 euro të depozituar në bankë, e cila është investuar dhe riinvestuar prej tij në vite deri në vitin 2014, kur është tërhequr *cash* shuma prej 50,000 euro. Nga verifikimi i dokumentacionit provues si më sipër ka rezultuar se të ardhurat e realizuara prej tij nga kontrata e shitjes së pasurisë së paluajtshme, i krijuan mundësinë financiare për t'i dhënë huan në vlerën 40,000 euro shtetasit F. G., me burime të ligjshme financiare. Në këto kushte ndryshon qëndrimi i mëparshëm i Komisionit lidhur me burimin e kësaj huaje, që pas administrimit të dokumentacionit të lartpërmendur shuma prej 40,000 euro konsiderohet me burime të ligjshme, për sa kohë pagesa e tatimeve mbi shumat e përfituara nga shitja e pasurive të paluajtshme kryhet detyrimisht dhe paraprakisht regjistrimit të pasurisë objekt tjetërsimi në emër të blerësit.
94. Shlyerja e një pjese të këtij detyrimi në vitin 2017 dhe një pjese në vitin 2020 provohet nga deklarata noteriale nr. \*\*\*, datë 30.7.2021, nga depozitimi i kryer në bankë nga shtetasi A. L. në vitin 2017 dhe nga transferta bankare në vlerën 20,000 euro, kryer nga babai i subjektit më 27.4.2020. Ky transaksion ka rezultuar i provuar edhe nga të dhënat e Drejtorisë së Përgjithshme të Parandalimit dhe Pastrimit të Parave, nga ku rezulton se në datën 27.4.2020 shtetasi F. G. ka kaluar në llogarinë e shtetasit A. L. shumën prej 20.000

euro me shënimin “kthim borxhi”. Lidhur me kthimin pas të huas në analizë, nga pasqyrat financiare të shoqërisë “E.” sh.p.k., për të cilën është marrë kjo hua, ka rezultuar se qarkullimet në vitet përkatëse 2017 dhe 2020 kanë qenë të mjaftueshme për shlyerjen e saj. Ndonëse periudha e kthimit të huas *de qua* është post deklaratës *Vetting* dhe huaja rezultoi me burime të ligjshme, Komisioni e ka vlerësuar këtë fazë (të shlyerjes) edhe për qartësimin e mëtejshëm lidhur me përfituesit e efektit financiar të huas dhe shlyerësit *de facto* të këtij detyrimi, nga ku nuk rezultoi përfshirja e subjektit.

95. Lidhur me huan e marrë nga babai i subjektit, shtetasi F. G., nga shtetasi B. H., në parashtrimet e dërguara nga subjekti, në lidhje me burimin e ligjshëm të saj janë paraqitur dokumente dhe shpjegime jobindëse mbi mjaftueshmërinë në kuptimin e nenit D të Aneksit të Kushtetutës. Lidhur me kthimin pas të shumës së marrë hua, subjekti ka bërë me dije se babai dhe vëllai i saj kanë përdorur si burim për kthimin e huas vetë shumën e marrë hua. Kjo, pasi vlera e saj nuk është konsumuar, por vetëm është përdorur (qarkulluar) për furnizime, pra për blerje materialesh për shoqërinë tregtare të vëllait dhe pasi këto materiale janë rishitur nga shumet e fituara është kthyer sërish pas huaja. Nga pasqyrat financiare të shoqërisë “E.” sh.p.k. ka rezultuar se qarkullimet dhe fitimet në vitet përkatëse kanë qenë të mjaftueshme për të justifikuar financiarisht kthimin e kësaj shume me burime të ligjshme.
96. Në vijim të sa më lart vërehet se ndonëse janë kryer hetime të plota dhe është pyetur subjekti mbi burimet e ligjshme të huadhënësit, pas prapësimeve të subjektit, në vlerësim të një sërë rrethanash që përjashtojnë përfshirjen e subjektit në këtë marrëdhënie financiare, trupi gjykues - duke mbajtur në vëmendje: (i) faktin se kjo hua është marrë nga babai i subjektit të rivlerësimit në tetor të vitit 2016, pasi subjekti ishte shkëputur ligjërisht nga trungu familjar<sup>41</sup> (moment i cili do të mund të ndikojë në përcaktimin dhe vlerësimin ligjor nëse kjo hua duhet të trajtohet si e marrë nga personi i lidhur, pra nga babai i subjektit të rivlerësimit, në kuptim të ligjit nr. 84/2016); (ii) destinacionin e përdorimit të shumës së marrë hua nga babai i subjektit dhe burimet me të cilat ajo është shlyer; (iii) mospërfshirjen e subjektit as për përdorimin (qoftë edhe të pjesshëm) të kësaj huaje dhe mospasjen të ndonjë kontributi të subjektit as për kthimin pas të kësaj shume - e çmon jopenalizues pamundësinë financiare të huadhënësit, për sa kohë kjo shumë nuk është investuar në pasuri familjare të subjektit apo të vetë subjektit, por është përdorur përkohësisht nga shoqëria tregtare e vëllait të saj dhe, më pas, është kthyer pas te huadhënësi. Ky qëndrim i trupës bazohet në kombinimin e dispozitave ligjore përkatëse dhe në konstatimet faktike të konstatuara në vijim të një analize të detajuar të rrethanave, të dinamikës dhe të momenteve të përfitimit të huas *de qua*, të përdorimit të shumave monetare të përfituara nëpërmjet kësaj huamarrjeje, kohës së kthimit dhe personave dhe fondeve të impenjuara për shlyerjen e saj. Nga një vlerësim i përgjithshëm që ka gërshetuar të dhënat faktiko-ligjore përkatëse, ka rezultuar se konkretisht përdorimi i huas së marrë nga shtetasi B. H. dhe kthimi pas i saj janë kryer vetëm në funksion të shoqërisë tregtare dhe me gjendjet financiare të kësaj shoqërie, nga vëllai i subjektit, në bashkëpunim me babain e vet. Kësisoj këto marrëdhënie financiare *de facto* nuk kanë pasur asnjë pikë takimi

<sup>41</sup>Në përgjigje të pyetësorit nr. 2, subjekti ka paraqitur certifikatën familjare nga e cila rezulton se është shkëputur nga trungu familjar në datën 7.7.2016.



me subjektin, për sa kohë nuk ka pasur ndonjë përfitim apo kontribut prej kësaj të fundit lidhur me këtë hua apo shoqëri. Pra, nuk janë konstatuar fakte apo rrethana që mund të evidentonin lidhje të subjektit me marrëdhënien financiare të marrjes dhe të kthimit të huas *de qua*, për sa kohë nuk rezulton se ka prodhuar efekte pasurore ndaj subjektit, në mënyrë direkte apo indirekte, në kushtet që as familja e saj nuk rezulton të ketë përfituar të mira materiale apo monetare as nga huaja e as nga shoqëria tregtare në periudhën në analizë.

97. Në këto kushte, trupi gjykues çmon se - për sa kohë nga aktet e administruara provohet se nuk ka rezultuar ndonjë indicie apo rrethanë faktike që të përfshijë, në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë, subjektin e rivlerësimit në këtë marrëdhënie huaje (marrje dhe kthim), parë rrethanat faktiko-ligjore të lartpërmendura, dhe duke mbajtur në vëmendje frymën e ligjit nr. 84/2016, si dhe jurisprudencën e Kolegjit të Posaçëm të Apelit<sup>42</sup> – në këtë rast pamundësia financiare e huadhënësit të babait, të shumave të përdorura për biznesin e vëllait (i cili në atë periudhë ishte jashtë certifikatës dhe familjes *de facto* dhe banesës së subjektit) nuk mund të penalizojë subjektin e rivlerësimit, në aspektin e vlerësimit të besueshmërisë së saj në raport me procesin e rivlerësimit pasuror të saj, pasi jo vetëm që nuk është impaktuar pasuria e saj personale apo familjare, por në sajë edhe të pozicionit specifik të subjektit brenda familjes në atë periudhë – as nuk rezulton që ajo të ketë qenë aktive dhe në dijeni të kryerjes së marrëdhënies financiare në fjalë nga të afërmit e saj, përkundrazi, krijohet bindja se duke mos u marrë me biznesin e vëllait, subjekti nuk ka pasur dijeni as për huan në fjalë.

### **REZULTATET E ANALIZËS FINANCIARE**

98. Në vijim të analizës financiare të kryer mbi deklaratimet periodike ndër vite të subjektit, pas përlllogaritjeve të kryera në mënyrë të detajuar sipas viteve, në Aneksin 1 që i bashkëngjitet këtij dokumenti janë paraqitur të gjitha të dhënat mbi të ardhurat, shpenzimet, kursimet, detyrimet dhe nga përlllogaritja krahasimore e tyre mund të vlerësohet dhe konkludohet mbi mjaftueshmërinë e burimeve financiare, për çdo vit, për të përballuar investimet, shpenzimet apo kursimet e deklaruara dhe/ose të konstatuara me të ardhura nga burime të ligjshme, në kuptim të nenit D të Aneksit të Kushtetutës.
99. Në analizën e njoftuar subjektit, në të cilën ishin konsideruar dhe përpunuar të dhënat duke filluar nga viti 2012, vit në të cilin fillon edhe deklarimi i pasurisë nga subjekti i rivlerësimit në ILDKPKI, ka rezultuar një bilanc i përgjithshëm negativ për të kryer të gjitha investimet, shpenzimet dhe kursimet e deklaruara apo të konstatuara nga Komisioni, duke përfshirë aty edhe disa posedime e qarkullime të mjeteve monetare, të rezultuara në emër të prindërve të subjektit, të cilat janë njoftuar si pjesë e rezultateve të hetimit administrativ.

### **Qëndrimi i subjektit në lidhje me analizën financiare**

100. Në lidhje me rezultatet e analizës financiare subjekti ka shprehur pretendimet për të kundërshtuar rezultatin – përveç atyre të trajtuara në vlerësimin e pasurive përgjatë vendimit – si vijon:

---

<sup>42</sup>Lidhur me qëndrimin e mbajtur nga Kolegji, në një rast të ngjashëm, në vendimin nr. 18, datë 26.7.2019.

- a. Analiza financiare duhet të fillojë nga tetori i vitit 2012, kur është momenti i fillimit të detyrës dhe jo i gjithë viti financiar.
- b. Të shtohet kontributi i dhënë nga vëllai E. G., nga të ardhurat e tij nga personi fizik edhe pas shkëputjes së tij nga familja në vitin 2012.
- c. Të zbriten shpenzimet e udhëtimit të motrës për 3 udhëtime drejt Turqisë, të cilat janë paguar nga Shkolla e Magjistraturës.
- d. Të sistemohen ditët e qëndrimit për udhëtimet e babait me traget, pasi nisja dhe kthimi është bërë në darkë dhe mbërritja në mëngjes, për rrjedhojë, fjetja ka qenë në traget.
- e. Për të gjitha udhëtimet e babait, përveç dy udhëtimeve turistike në Spanjë dhe Greqi, të zbriten shpenzimet pasi janë kryer prej tij në kuadër të aktiviteteve tregtare, për takime me furnitorët dhe këto shpenzime janë përballuar nga shoqëritë dhe vëllezërit e subjektit.

### **Vlerësimi i trupit gjykues**

101. Në vijim të analizimit të pretendimeve të subjektit mbi analizën financiare është rishikuar kjo e fundit sa i përket udhëtimeve me traget të babait të subjektit, ku Komisioni ka sistemuar numrin e ditëve të qëndrimit për 7 udhëtime me traget, si dhe ka zbritur shpenzimet për transportin dhe qëndrimin e motrës së subjektit gjatë udhëtimeve me destinacion Turqinë, të mbuluara këto nga Shkolla e Magjistraturës dhe pritësit. Njësia ligjore ka kryer analizën financiare, duke filluar nga muaji tetor 2012, në të cilën ka filluar edhe detyra e subjektit të rivlerësimit.
102. Lidhur me pretendimet e subjektit, mbi mbulimin e shpenzimeve të udhëtimit të babait nga shoqëritë tregtare të vëllezërve të saj, nga shqyrtimi i bilanceve të shoqërive dhe anekseve shpjeguese të tyre nuk ka rezultuar ndonjë vlerë shpenzimesh për udhëtime dhe dieta. Për rrjedhojë, ky pretendim gjendet i pabazuar.
103. Lidhur me pretendimin e subjektit mbi përfshirjen në analizë të familjes, edhe të ardhurat e realizuara nga aktiviteti i vëllait, E. G. person fizik, edhe pas shkëputjes së tij fizikisht nga trangu familjar, trupi gjykues çmon se – për sa kohë këto shuma të dhëna janë përdorur nga nëna e tij për t'i investuar në një depozitë me afat, shumë kjo e cila në përfundim, pas tërheqjes ka qenë sërish e destinuar për të birin, E. G. – këto të ardhura duhet të përfshihen në analizën financiare. Pas përfshirjes së tyre, rezultati financiar për periudhën tetor 2012 – 2016, balanca negative rezulton të jetë në masën 115,892 lekë, siç është detajuar në tabelën më poshtë.
104. Trupi gjykues vlerëson se edhe nëse ky pretendim i subjektit nuk do të pranohej, sërish balanca e analizës financiare do të rezultonte me një pamjaftueshmëri financiare në masën 995,237 lekë, rezultat ky i cili, i parë nën dritën e parimit të proporcionalitetit dhe objektivitetit, gjithsesi nuk do të vlerësohej shkak i mjaftueshëm për aplikimin e masës së shkarkimit nga detyra të znj. Diamela Goxha, sipas parashikimeve të nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe/ose të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016.

105. Për rrjedhojë, trupi gjykues vlerëson se znj. Diamela Goxha ka arritur një nivel të besueshëm në lidhje me kriterin e pasurisë, duke justifikuar dhe shpjeguar bindshëm të gjitha pasuritë e analizuar, ku rezultoi të ishte e përfshirë.

#### Analiza financiare për periudhën tetor 2012 – 2016

Viti	Tet-Dhj 2012	2013	2014	2015	2016
<b>PASURI</b>	<b>15,790</b>	<b>1,098,842</b>	<b>-1,191,254</b>	<b>110,697</b>	<b>674,465</b>
Automjet në b/pronësi VW Golf					
Apartament në përdorim Rr. I. Q.					
Ndryshim likuiditeti	15,790	1,098,842	-1,191,254	110,697	674,465
TOTAL LIKUIDITETE DEKLARUAR	2,482,038	3,580,880	2,389,626	2,500,323	3,174,787
<b>DETYRIME</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>7,506,000</b>	<b>970,056</b>
Kredi bankare në Raiffeisen Bank					970,056
Kredi bankare në BKT Xh.G.				2,000,000	-2,000,000
Kredi bankare në BKT Xh.G.					2,000,000
Marrë/kthyer hua shtetasit A. L.				5,506,000	
<b>PASURI NETO</b>	<b>15,790</b>	<b>1,098,842</b>	<b>-1,191,254</b>	<b>-7,395,303</b>	<b>-295,591</b>
<b>Të ARDHURA dokumentuar</b>	<b>528,953</b>	<b>2,165,853</b>	<b>1,972,881</b>	<b>2,169,885</b>	<b>2,557,434</b>
Të ardhura të SR të vërtetuara	194,840	805,529	987,585	977,941	971,635
Të ardhura të motrës të vërtetuara	26,028	360,319	689,689	635,916	1,014,244
Të ardhura të babait të vërtetuara				170,126	185,592
Të ardhura të nënës të vërtetuara	84,152	170,005	295,607	385,902	385,963
Të ardhura të vëllait të vërtetuara	223,933	830,000			
<b>SHPENZIME</b>	<b>338,574</b>	<b>1,182,904</b>	<b>1,294,220</b>	<b>8,968,926</b>	<b>2,015,122</b>
Shpenzime jetese	141,024	564,096	879,992	897,104	940,368
Shpenzime udhëtimi	179,001	618,808	354,598	397,214	352,998
Shpenzime transporti			45,000		45,000
Shpenzime interesi të kredisë				162,758	260,956
Të shpenzuara nga kredia					400,000
Shpenzime siguracioni të automjetit	18,550		14,630	15,850	15,800
Dhënë hua E.G.				7,496,000	
<b>Analiza dokumentuar</b>	<b>174,588</b>	<b>-115,892</b>	<b>1,869,914</b>	<b>596,262</b>	<b>837,904</b>
CASH në Lekë				90,000	600,000
<b>DIFERENCA E PA MBULUAR</b>			<b>-115,892</b>		

### B. KONTROLLI I FIGURËS

106. Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (DSIK) ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit. Për këtë qëllim, në përputhje me nenin 39 të ligjit nr. 84/2016, është përcjellë në Komision raporti nr. \*\*\* prot., datë 31.10.2017, për subjektin e rivlerësimit, me të cilin ishte konstatuar përshtatshmëria e subjektit të rivlerësimit Diamela Goxha.
107. Në përgjigje të kërkesës së Komisionit për përditësimin e rastit në fjalë, nga DSIK-ja janë përcjellë disa shkresa përditësuese, konkretisht, të datave 31 maj dhe 2 e 16 qershor 2021, nëpërmjet të cilave bëhet me dije se edhe për periudhën pas raportit të lartpërmendur, nuk

disponohen të dhëna mbi përfshirje të mundshme në aktivitete të kundërligjshme për subjektin e rivlerësimit Diamela Goxha. Gjithashtu, DSIK-ja i ka bërë me dije Komisionit se raporti mbi kontrollin e figurës për subjektin e rivlerësimit Diamela Goxha ishte deklasifikuar plotësisht më 26.5.2021.

108. Për rrjedhojë, në vijim të komunikimeve me organet ligjzbatuese dhe përgjatë hetimit administrativ të kryer nga Komisioni, për sa kohë nuk kanë rezultuar informacione apo fakte/rrethana të reja për subjektin e rivlerësimit, lidhur me këtë kriter, që mund të ngrinin dyshime mbi bazueshmërinë e konkluzioneve të arritura nga Grupi i Punës, pranë DSIK-së, edhe trupi gjykues e vlerëson subjektin e rivlerësimit të përshtatshëm për të vijuar detyrën e gjyqtarës.

## C. RIVLERËSIMI I AFTËSIVE PROFESIONALE

### C/1. Lidhur me analizën e aftësive profesionale nga KLGJ-ja

109. KLGJ-ja ka përcjellë në Komision, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 9.6.2021, raportin e përpiluar nga ky institucion për analizimin e aftësive profesionale bazuar në ligjin nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” dhe në ligjin nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, të subjektit të rivlerësimit Diamela Goxha.
110. Në raportin e KLGJ-së janë analizuar të dhënat e rezultuara nga dokumentet, duke iu referuar kriterëve të mëposhtme të vlerësimit: (i) aftësive profesionale; (ii) aftësive organizative; (iii) etikës dhe angazhimit ndaj vlerave profesionale; dhe (iv) aftësive personale dhe angazhimit profesional. Raporti në fjalë është hartuar bazuar në përshkrimin dhe analizimin e: (i) formularit të vetëdeklarimit; (ii) të tri dokumenteve ligjore të përzgjedhura nga subjekti i rivlerësimit, (iii) pesë dosjeve gjyqësore, të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor; (iv) të dhënave nga burimet arkivore të KLGJ-së.
111. Sipas këtij raporti: (i) subjekti i rivlerësimit Diamela Goxha ka aftësi shumë të mira në drejtim të interpretimit dhe të zbatimit të ligjit. Në tri dokumentet ligjore dhe në pesë dosjet e vëzhguara është konstatuar se identifikon normën ligjore të zbatueshme dhe jep arsye për mënyrën e zbatimit të saj në rastin konkret; (ii) gjyqtarja, përgjithësisht, përdor shprehimisht parimet e përgjithshme të së drejtës si parimi i zhvillimit të një procesi të rregullt ligjor, parimin e disponibilitetit të padisë. Përrjashtimisht është evidentuar si e vetmja mangësi ligjore në dosjen nr. 2, ku është konkluduar se: *“Konstatohet se propozimi i ndihmësligjorit Diamela Goxha për mënyrën e zgjidhjes së çështjes nuk përputhet me vendimmarrjen e Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, i cili ka arsyetuar dhe vendosur ndryshe nga sa është propozuar nga subjekti i rivlerësimit”*. Për t’u vlerësuar gjithashtu është fakti që gjyqtare Diamela Goxha në vendimet e dhëna prej saj, kur është rasti, përdor referenca nga jurisprudenca e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, nga jurisprudenca unifikuese e Gjykatës së Lartë, etj.

112. Së fundi, ndër tri vendimet gjyqësore të vëzhguara, dy prej tyre nuk kanë rezultuar të cenuara nga Gjykata e Apelit apo nga Gjykata e Lartë<sup>43</sup>. Subjekti i rivlerësimit Diamela Goxha, në cilësinë e gjyqtares, ka shfaqur aftësi shumë të mira në arsyetimin ligjor. Në cilësinë e ndihmësligjorit në Gjykatën e Lartë evidentohen cilësi të mira në arsyetimin ligjor në 6 relacionet e vëzhguara.
113. Në lidhje me detyrën e ndihmësligjorit të kryer nga znj. Diamela Goxha në Gjykatën e Lartë, në aktvlerësimet e kësaj të fundit, kryer për periudhat 2014 - 2015 dhe prill 2015 - prill 2016, evidentohet fakti se subjekti i rivlerësimit jep mendime të argumentuara ligjërisht për zgjidhjen përfundimtare të çështjeve. Znj. Diamela Goxha është vlerësuar nga Gjykata e Lartë se është e aftë të shkruajë thjesht dhe qartë projektvendimet gjyqësore, që rezultojnë të kuptueshme nga të gjithë.

## **C/2. Rivlerësimi i aftësive profesionale nga Komisioni**

114. Komisioni, në bazë të neneve 40 - 44 të ligjit nr. 84/2016, pasi ka analizuar raportin e KLGj-së, si dhe dokumentacionin e bashkëlidhur, ka kryer rivlerësimin e aftësive profesionale në përputhje me nenin E të Aneksit të Kushtetutës, duke shqyrtuar edhe informacionet e marra nga denoncimet nga publiku, si dhe duke analizuar aktet/vendimet/dosjet profesionale të administruara për këtë qëllim.
115. Nga vlerësimi i tri dosjeve të përzgjedhura nga subjekti i rivlerësimit dhe pesë dosjeve të përzgjedhura sipas një sistemi rastësor/me short nuk janë konstatuar problematika apo shkelje të rënda lidhur me vlerësimin profesional të subjektit të rivlerësimit, tej atyre për të cilat ishte shprehur edhe KLGJ-ja dhe që trajtohen shkurtimisht në vijim:
116. Në lidhje me kohëzgjatjen e proceseve gjyqësore, referuar dokumentit nr. 2 të analizuar në aktin e KLGJ-së, në të cilin ky i fundit ka parashtruar se: *“Nuk është pasqyruar data e regjistrimit të çështjes dhe, rrjedhimisht, nuk mund të përcaktohet kohëzgjatja e gjykimit të saj”*, Komisioni, pas shqyrtimit të vendimi nr. \*\*\*, datë 17.3.2014, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat, ka arritur në konkluzionin se ky vendim i përket çështjes së regjistruar në datën 7.2.2014<sup>44</sup>, pranë kësaj gjykate dhe kohëzgjatja e gjykimit ka rezultuar brenda afatit 6-mujor të përcaktuar nga germa “e”, e pikës 5, të Aneksit 1, të Sistemit të Vlerësimit.
117. Në lidhje me mosvendosjen e datës së përpilimit të relacionit nga ndihmësligjori, nuk ka rezultuar ndonjë përcaktim ligjor apo format standard për përpilimin e tyre dhe as ndonjë përcaktim specifik në rregulloren e brendshme të institucionit. Për rrjedhojë, lidhur me këtë konstatim, nuk mund të ngarkohet me përgjegjësi subjekti i rivlerësimit.
118. Në lidhje me konstatimin për vendimmarrje të ndryshme të Kolegjit nga propozimi i subjektit në cilësinë e ndihmësligjorit, Komisioni vlerëson se bazuar në pikën 4, të nenit 72, të ligjit nr. 96/2016, *“Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”*, në të cilin parashikohet se: *“Vlerësuesi çmon aftësitë gjyqësore pa gjykuar korrektësinë e vendimit dhe themelin e çështjes, si dhe pa zëvendësuar interpretimin ose logjikën e gjyqtarit që vlerësohet”*. Në kuptim të këtij përcaktimi ligjor, gjykimi apo

<sup>43</sup>Shihni dokumentet 2 dhe 3.

<sup>44</sup>Gjykimi ka zgjatur gjithsej rreth 1 muaj dhe 10 ditë.

mendimi mbi zgjidhjen e një çështjeje gjyqësore nuk mund të jetë një alternativë vlerësimi e përdorur prej organeve të rivlerësimit, për sa kohë që gjykimi lidhet me vlerësimin dhe çmimin e provave dhe mbështetet mbi bindjen e brendshme në rastin konkret të shpalosur si pjesë e detyrës së ndihmësligjorit, pasi del jashtë misionit dhe kompetencës ligjore të organeve të rivlerësimit.

119. Komisioni ka kërkuar informacion nga Prokuroria e Përgjithshme në lidhje me procedime penale të mundshme të rezultuara në emër të subjektit. Në përgjigje të sa më sipër, Prokuroria e Përgjithshme<sup>45</sup> ka bërë me dije se në datën 11.11.2016, në emër të subjektit të rivlerësimit është regjistruar kallëzimi penal nr. \*\*\*, nga shtetasi M. K., për veprën penale “falsifikimi i dokumenteve” dhe “shpërdorimi i detyrës”, për të cilin është vendosur mosfillimi me vendimin nr. \*\*\*, datë 7.12.2016<sup>46</sup>. Vendimi i mësipërm nuk është ankimuar në gjykatë.
120. Në lidhje me kallëzimin penal të sipërpërkshkruar, nga shqyrtimi i dokumentacionit provues të paraqitur nga subjekti, ka rezultuar se ka proceduar sipas neneve 72-75 të Kodit të Procedurës Civile, në lidhje me shqyrtimin e kërkesës për përjashtimin e gjyqtarit të paraqitur nga denoncuesi. Për sa më sipër nuk kanë rezultuar shkelje procedurale të kryera nga subjekti i rivlerësimit.
121. Nisur nga sa më lart, në raport me sa ka rezultuar nga aktet dhe dokumentet e administruara, si dhe duke mbajtur në vëmendje shpjegimet e paraqitura nga subjekti ka rezultuar se kallëzimi është bërë nga shtetasi M. K. Ky shtetas ka paraqitur në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Berat kërkesën me objekt “përjashtimin e gjyqtarës L. C.” Kjo kërkesë është shqyrtuar nga subjekti i rivlerësimit Diamela Goxha, e cila me vendimin nr. \*\*\*, datë 22.10.2016, bazuar në nenet 72, 74 dhe 75 të Kodit të Procedurës Civile ka vendosur “Deklarimin si të papranueshme të kërkesës”, me arsyetimin se përjashtimi i gjyqtarit nuk mund të kërkohej nëpërmjet kërkesëpadisë, pasi gjyqtari që kërkohej të përjashtohet nuk mund të thirret në gjykim si i paditur.
122. Trupi gjykues çmon se duke e parë në tërësi rivlerësimin e aftësive profesionale, këto problematika nuk përbëjnë shkak penalizues, për sa kohë nuk kanë rezultuar shkelje të rënda procedurale dhe/ose mosrespektim i të drejtave të palëve, me pasoja për këta të fundit apo arsyetime të dobëta ose të paplota në vendimet e dhëna nga subjekti i rivlerësimit.

### **DENONCIME NGA PUBLIKU**

123. Në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit janë paraqitur 9 denoncime nga publiku, të cilat janë shqyrtuar së bashku me materialet përkatëse. Në vijim të analizimit të materialeve

---

<sup>45</sup>Shkresa nr. \*\*\* prot., datë 31.3.2021.

<sup>46</sup>Në lidhje me kallëzimin e rezultuar ndaj saj, subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar se bëhet fjalë për një kallëzim abuziv dhe të pambështetur në ligj, pasi më herët ajo kishte shqyrtuar kërkesëpadinë e tij për përjashtimin e një gjyqtari nga procesi ku ai ishte palë. Subjekti ka sqaruar se nga ana e saj janë respektuar dispozitat 72-75 të Kodit të Procedurës Civile, që kanë qenë në fuqi në kohën e gjyqimit dhe kërkesa është deklaruar e papranueshme me arsyetimin se përjashtimi i gjyqtarit duhet të kërkohej me kërkesë dhe jo me kërkesëpadi, si dhe nuk mund të thirret në cilësinë e të paditurit në proces gjyqtari ndaj të cilit është paraqitur kërkesa për përjashtim dhe personat e cilësuar si persona të tretë prej tij nuk gëzonin pozitën procedurale të personit të tretë referuar natyrës së kërkimit subjekti ka paraqitur në cilësinë e provës, dokumentacionin si vijon: vendim nr. \*\*\*, datë 22.10.2016, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat; vërtetim datë 10.9.2021, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat.

përkatëse, lidhur me disa denoncime, bazuar në nenin 53 të ligjit nr. 84/2016 janë administruar disa akte/dosje hetimore dhe gjyqësore, për vlerësime më të thella, lidhur me aspektin profesional të subjektit të rivlerësimit, nga ku ka rezultuar si vijon.

### **1. Denoncimi nr. \*\*\* prot., datë 1.8.2018, i shoqërisë R. B.**

124. Shoqëria R. B. ka depozituar denoncimin, në të cilin ngre pretendimin për vendimmarrje të njëanshme dhe joprofesionale nga subjekti i rivlerësimit, në lidhje me çështjen me objekt “pezullimi i veprimeve përbarimore deri në përfundim të gjykimit” me palë paditëse shtetasin I. M. dhe palë të paditur denoncuesin. Denoncuesi ka pretenduar gjithashtu se nga subjekti nuk janë respektuar përcaktimet e neneve 144, 203, 209 dhe 610 të Kodit të Procedurës Civile, si dhe se vendimi nuk është zbardhur brenda afatit. Kjo, sipas tij, ka shkaktuar humbjen e të drejtës për të ushtruar ankim në Gjykatën e Apelit ndaj kësaj vendimmarrjeje.
125. Nga analiza e vendimit<sup>47</sup> ka rezultuar se gjykimi është zhvilluar në prani të palëve (denoncuesi/i padituri ka qenë prezent) dhe shpallja e vendimit është bërë në përputhje me përcaktimet e nenit 202 të Kodit të Procedurës Civile. Gjithashtu, në vendim disponohet për të drejtën e palëve për ankimin, konkretisht, në vendim citohet se: “... *palët kanë të drejtë ankimi brenda 5 ditëve nga e nesërmja e njoftimit të arsyetimit të vendimit*”.
126. Në përgjigje të pyetësorit nr. 2 të dërguar nga Komisioni, subjekti ka deklaruar se arsyetimi i vendimit është bërë prej saj brenda afatit 3-ditor të përcaktuar në Kodin e Procedurës Civile<sup>48</sup>. Në lidhje me dokumentacionin provues që provon zbardhjen e vendimit nr. \*\*\* regj.them. datë 20.7.2018, subjekti ka sqaruar se Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kavajë nuk disponon një regjistër të veçantë, ku regjistrohet depozitimi i vendimeve të ndërmjetme. Gjithashtu, sistemi elektronik i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kavajë nuk mundëson hedhjen e vendimeve të ndërmjetme në sistem.
127. Nga aktet e administruara rezulton se nga ana e sekretarisë është komunikuar në një dëftesë të vetme edhe vendimi i ndërmjetëm<sup>49</sup> dhe ankimi i palës. Referuar dispozitivit të vendimit, e drejta e ankimit për palët ka filluar nga momenti i marrjes dijeni për vendimin e arsyetuar të gjykatës. Kjo dosje është nisur në Gjykatën e Apelit Durrës më 4.9.2018 dhe rezulton të jetë regjistruar pranë kësaj të fundit më 13.9.2018, çka e provon edhe vërtetimi datë 21.7.2021, i lëshuar nga kjo gjykatë, i paraqitur nga subjekti në cilësinë e provës.
128. Për sa më sipër, nga verifikimi i fakteve të trajtuara në denoncim, rrethanave të rezultuara nga hetimi, si dhe shpjegimeve të paraqitura nga subjekti, në lidhje me këtë denoncim

---

<sup>47</sup>Në përgjigje të kërkesës së dërguar nga Komisioni, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kavajë, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 7.6.2021, ka përcjellë vendimin nr. \*\*\* regj., them., datë 20.7.2018, nga i cili ka rezultuar se çështja objekt denoncimi ka qenë e regjistruar në këtë gjykatë në datën 16.7.2018.

<sup>48</sup>Për të provuar zbardhjen në afat të vendimit të sipërcituar, subjekti ka paraqitur dëftesat e komunikimit të vendimit nga ku rezulton se nga ana e kryesekretarisë në datën 26.7.2018, ku u është komunikuar palëve, vendimi nr. \*\*\*, datë 20.7.2018.

<sup>49</sup>Kopje e vërtetimit të njoftimit të vendimit të ndërmjetëm datë 20.7.2018 e paraqitur nga subjekti në përgjigje të pyetësorit nr. 2.

nuk janë konstatuar shkelje procedurale nga subjekti i rivlerësimit apo mangësi profesionale të subjektit të rivlerësimit.

## **2. Denoncimi nr. \*\*\* prot., datë 16.2.2018, i shtetasit E. M.**

129. Shtetasi E. M. ka depozituar denoncimin në lidhje me vendimin nr. \*\*\*, të datës 22.1.2018, të dhënë nga subjekti i rivlerësimit me objekt “heqjen e pensionit ushqimor ndaj fëmijës madhor”, ndaj të cilit ngre pretendime për vendimmarrje në kundërshtim me ligjin, por nuk përshkruan shkelje procedurale specifike. Në këtë vendim subjekti ka vendosur rrëzimin e kërkesëpadisë së ngritur prej shtetasit E. M./denoncuesit.
130. Për sa më sipër, nuk janë konstatuar *indicie* për thellimin e hetimit, pasi denoncimi nuk ka referuar ndonjë provë apo shkelje procedurale konkrete të subjektit të rivlerësimit, për sa kohë pretendimet e denoncuesit nuk japin *indicie* konkrete dhe kanë të bëjë kryesisht me themelin e çështjes.

## **3. Denoncimi nr. \*\*\* prot., datë 29.1.2019, i shtetasit V. T.**

131. Shtetasi V. T. ka depozituar denoncimin, në të cilin ngre pretendime për vendimmarrje të padrejtë dhe të pabazuar në prova nga subjekti i rivlerësimit, por nuk përshkruan shkelje procedurale specifike. Pretendimet denoncuesi i ngre në lidhje me vendimin nr. \*\*\*, të datës 6.10.2018, për të cilin subjekti ka vendosur pranimin e kërkesës së Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kavajë, për “vleftësimin e arrestit dhe caktimin e masës së sigurimit personal”, ndaj të dyshuarit shtetasit V. T., për kryerjen e veprës penale “dhunë në familje”, parashikuar nga germa “a”, e pikës 4, të nenit 134, të Kodit Penal.
132. Në vendim, subjekti ka arsyetuar në referencë të përcaktimeve të neneve 228/3, 229/1/2, si dhe nenit 230 të Kodit të Procedurës Penale. Kërkesa ka rezultuar e regjistruar në datën 6.10.2018 në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kavajë. Caktimi i seancës ka rezultuar brenda afatit 48 orë të parashikuar në pikën 1, të nenit 18, të ligjit nr. 9669, datë 18.12.2006, “Për masat ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”. Gjithashtu, nga analiza e vendimit ka rezultuar se janë respektuar të drejtat procedurale të palëve, konkretisht, të ndaluarit i është caktuar mbrojtës kryesisht, i janë bërë me dije faktet dhe provat dhe shkaqet e arrestimit/ndalimit, si dhe në vendim disponohet për të drejtën e ankimit.
133. Nisur nga fakti që pretendimet e denoncuesit janë shprehje të karakterit të përgjithshëm dhe nuk referojnë ndonjë provë apo shkelje procedurale konkrete nga subjekti i rivlerësimit, nuk janë konstatuar *indicie* për thellimin e mëtejshëm të hetimit.

## **4. Denoncimi nr. \*\*\* prot., datë 26.2.2019, i shtetasës S. H.**

134. Shtetasja S. H. ka depozituar denoncimin, në të cilin ngre pretendime për dënimin e padrejtë të saj nëpërmjet vendimit të datës 28.1.2019 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kavajë, por nuk referon ndonjë provë apo shkelje procedurale konkrete nga subjekti i rivlerësimit. Nga analiza e vendimit<sup>50</sup> ka rezultuar se nëpërmjet tij është vendosur dënimi i të pandehurës me 3 muaj burgim.

---

<sup>50</sup>Komisioni i është drejtuar me kërkesë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kavajë, e cila me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 7.6.2021, paraqiti vendimin nr. \*\*\*, datë 28.1.2019.



135. Vendimi i sipërcituar ka rezultuar<sup>51</sup> i lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit Durrës<sup>52</sup>, e në vijim ky i fundit ka rezultuar i ankimuar në Gjykatën e Lartë, e cila nëpërmjet vendimit nr. \*\*\*, të datës 24.2.2021, ka vendosur mospranimin e rekursit të paraqitur nga denoncuesja.
136. Për sa më sipër, bazuar në faktet e rezultuara nga hetimi, si dhe shpjegimet e paraqitura nga subjekti, në lidhje me këtë denoncim nuk janë konstatuar shkelje procedurale nga subjekti i rivlerësimit, sikurse as Gjykata e Apelit nuk ka ngritur dyshime mbi shkelje të mundshme procedure, ndërkohë që denoncimi në fjalë i referohet themelit të çështjes gjyqësore, e cila nuk është objekt shqyrtimi përgjatë procesit të rivlerësimit.

#### **5. Denoncimi nr. \*\*\* prot., datë 8.3.2019, i shtetasit N. H.**

137. Shtetasi N. H., nëpërmjet formularit të denoncimit, ka denoncuar disa subjekte rivlerësimi dhe ndërmjet tyre edhe gjyqtaren Diamela Goxha për vendimmarrje të padrejtë dhe shkelje të procedurave në çështjen e gjykuar prej saj, në të cilën denoncuesi ka qenë i paditur. Konkretisht, në vendimin nr. \*\*\*, datë 4.12.2018, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kavajë, në të cilin ka vendosur “Pranimin pjesërisht të kërkesës për pezullimin e procedurës përmbarimore”.
138. Denoncuesi ka pretenduar se vendimmarrja ka qenë e padrejtë, pasi shtetasja F. D. nuk gëzonte legjitimitet në ngritjen e padisë, sipas kërkesave të nenit 612 të Kodit të Procedurës Civile, si dhe ka pretenduar se nëpërmjet vendimit të sipërcituar i janë shkelur disa të drejta kushtetuese si: e drejta e pronës private dhe garancitë ligjore të saj, parimi i barazisë përpara ligjit, parimi i sigurisë juridike dhe e drejta për një proces të rregullt ligjor.
139. Nga analiza e vendimit ka rezultuar se subjekti i rivlerësimit, në arsyetimin e vendimit, i është referuar përcaktimeve të neneve 202<sup>53</sup>, 203<sup>54</sup> dhe nenit 612<sup>55</sup>. Përgjatë hetimit administrativ ka rezultuar se vendimi i sipërcituar ka rezultuar i ankimuar në Gjykatën e Apelit Durrës, e cila me vendimin nr. \*\*\*, datë 19.2.2019, ka vendosur: “Lënien në fuqi të vendimit nr. \*\*\* regj., datë 4.12.2018, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kavajë”. Në vijim, denoncuesi ka paraqitur rekurs në Gjykatën e Lartë, e cila me vendimin nr. \*\*\*, datë 11.11.2020, ka vendosur mospranimin e rekursit të paraqitur nga pala e denoncuesit, kundër vendimit nr. \*\*\*, datë 19.2.2019, të Gjykatës së Apelit Durrës. Në këto kushte nuk janë konstatuar shkelje procedurale konkrete nga subjekti i rivlerësimit, për më tepër

<sup>51</sup>Nga verifikimi i kryer nga Komisioni në faqen e Gjykatës së Apelit Durrës.

<sup>52</sup>Me vendimin nr. \*\*\*, datë 2.7.2019, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të gjykatës së shkallës së parë me këtë ndryshim: Në zbatim të nenit 59 të Kodit Penal urdhërohet pezullimi i ekzekutimit të dënimit me burgim duke u vënë e pandehura në provë për një periudhë kohe prej 6 muajsh, kohë gjatë së cilës duhet të mbajë kontakte me Zyrën e Shërbimit të Provës Kavajë.

<sup>53</sup>Me kërkesën e paditësit, gjykata, brenda 5 ditëve lejon marrjen e masave për sigurimin e padisë, kur ka arsye të dyshohet se ekzekutimi i vendimit për të drejtat e paditësit do të bëhet i pamundur ose i vështirë. Sigurimi i padisë lejohet kur: (a) padia mbështetet në prova me shkresë; (b) paditësi jep garanci, në masën dhe në llojin e caktuar nga gjykata, për dëmin që mund t'i shkaktohet të paditurit nga sigurimi i padisë. Garancia mund të kërkohej edhe për rastin e parashikuar nga germa “a” e këtij neni.

<sup>54</sup>Sigurimi i padisë lejohet për të gjitha llojet e padive dhe në çdo fazë të gjykimit, derisa vendimi të marrë formë të prerë. Sigurimi i padisë lejohet edhe nga Gjykata e Apelit, kur padia është duke u shqyrtuar prej saj.

<sup>55</sup>Sipas të cilit çdo person i tretë që pretendon se është pronar i sendit mbi të cilin bëhet ekzekutimi, mund të ngrejë padi për të ushtruar të drejtën e tij dhe kur është rasti për të përjashtuar sendin nga sekuestrimi dhe shitja. Padia ngrihet kundër kreditorit dhe debitorit në gjykatën e vendit të ekzekutimit të vendimit. Në këto raste, gjykata mund të vendosë si masë të përkohshme pezullimin e ekzekutimit me ose pa garanci.

që përmbajtja e denoncimit në analizë lidhet kryesisht me themelin e çështjes gjyqësore në fjalë.

#### **6. Denoncimi nr. \*\*\* prot., datë 9.3.2021, i shtetasit H. Gj.**

140. Shtetasi H. Gj. ka depozituar denoncimin, në të cilin ngre pretendime për moscaktivim të datës së seancës gjyqësore nga subjekti i rivlerësimit në lidhje me kërkesëpadinë e depozituar prej tij në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kavajë në datën 11.9.2020. Denoncuesi ka pretenduar marrjen e masave ndaj subjektit të rivlerësimit, por nuk ka përshkruar shkelje procedurale specifike, si dhe nuk ka paraqitur të dhëna/prova lidhur me pretendimet e tij.
141. Në përgjigje të pyetësorit nr. 2<sup>56</sup>, në datën 23.7.2021, subjekti ka deklaruar se kjo çështje është regjistruar më 14.9.2020<sup>57</sup>, në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kavajë dhe është ende në gjykim prej saj.
142. Në lidhje me kohëzgjatjen e këtij gjykimi subjekti ka parashtruar se asnjëra prej seancave gjyqësore nuk është shtyrë për shkak të mungesës së saj, si dhe ka bërë me dije se gjykatat kanë qenë për disa muaj të mbyllura për shkak të pandemisë Covid-2019 dhe janë gjykuar çështjet që kanë pasur karakter urgjent dhe kjo ka sjellë një rritje të ngarkesës në lidhje me çështjet e tjera.
143. Në përfundim ka rezultuar se çështja objekt gjykimi nuk hyn në kategorinë e çështjeve, për të cilat ligji ka parashikuar afat të posaçëm gjykimi dhe, për rrjedhojë, gjykimi duket se është në përputhje me afatin që parashikon Kodi i Procedurës Civile dhe afatet orientuese të KLGJ-së.

#### **7. Denoncimi nr. \*\*\* prot., datë 5.4.2019, nga shoqëria “D” sh.p.k.**

144. Denoncuesi ka paraqitur kërkesën e datës 5.4.2019, në të cilën ka pretenduar se për çështjen gjyqësore të gjykuar nga subjekti i rivlerësimit, në të cilën ka qenë palë, shoqëria përmbarimore dhe banka kanë krijuar rrethanat e prezumimit të pagesës së shërbimit përmbarimor me qëllim shmangien e pagesës së tatimit mbi vlerën e shtuar.

---

<sup>56</sup>Komisioni i është drejtuar me kërkesë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kavajë, e cila me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 7.6.2021, ka bërë me dije se çështja e sipërcituar është ende në gjykim. Në vijim, Komisioni iu drejtua subjektit nëpërmjet pyetësorit nr. 2, duke i kërkuar të paraqesë informacion në lidhje me fazat e çështjes së shqyrtuar, duke specifikuar datat e regjistrimit dhe shortimit të çështjes dhe marrjes në dorëzim nga subjekti.

<sup>57</sup>Në bazë të shortit elektronik të të njëjtës datë, çështja i është ngarkuar subjektit për gjykim. Në datën 26.9.2020 ka urdhëruar sekretarinë gjyqësore për të kryer veprimet përkatëse duke njoftuar palën e paditur për padinë dhe aktet provuese, si dhe i është bërë me dije e drejta për të lëshuar deklaratën e mbrojtjes, jo më vonë se 30 ditë nga njoftimi. Në datën 22.10.2020, të paditurit kanë marrë dijeni për padinë dhe është pritur kalimi i afatit 1-mujor të paraqitjes së deklaratës së mbrojtjes, si dhe është pritur paraqitja e saj nëpërmjet shërbimit postar nga palët. Në datën 20.11.2020 është paraqitur deklarata e mbrojtjes nga ana e palës së paditur studio përmbarimore “L.” Tiranë. Ndërkohë që është pritur nga ana e gjykatës edhe paraqitja e deklaratës së mbrojtjes nga ana e të paditurit tjetër në proces shoqëria “F. K.” sh.p.k., nëpërmjet shërbimit postar kjo e fundit nuk ka paraqitur deklarata mbrojtjeje. Deklarata e mbrojtjes së palës së paditur studio përmbarimore “L.” Tiranë i është komunikuar palës paditëse H. Gj., në datën 22.12.2020. Më 1.2.2021, nga ana e sekretarisë janë kryer njoftimet duke u njoftuar palët për seancën përgatitore më 13.4.2021, e cila është shtyrë pasi njoftimi për palën e paditur shoqëria “F. K.” sh.p.k. është kthyer me shënimin nuk ndodhet asnjë person fizik. Seanca është shtyrë për në datën 6.5.2021, e cila është shtyrë mbi bazën e kërkesës së palës paditëse H. Gj. për të thirrur në cilësinë e të paditurit në proces edhe të paditurën V. S., e cila ka cilësinë e kreditores. Seanca është shtyrë për në datën 18.6.2021 për t’i lënë një kohë të mjaftueshme palës së paditur V. S. për të paraqitur deklaratën e mbrojtjes. Në datën 18.6.2021, gjykata ka urdhëruar kalimin e çështjes në seancë gjyqësore. Seanca e datës 2.7.2021 është shtyrë për shkak të përsëritjes së njoftimit të palës së paditur nëpërmjet afishimit të njoftimit pranë QKB-së për shoqërinë, si dhe paraqitjen personalisht të saj/administratorit të saj, si dhe njoftimin e ASHK Dega Vendore Kavajë, për të vendosur në dispozicion kartelat e pasurive. Seanca e ardhshme ishte planifikuar për t’u zhvilluar më 29.7.2021, ora 13:30.

145. Denoncuesi ka pretenduar se nuk janë zbatuar kërkesat procedurale të parashikuara nga nenet 203 dhe 515 të Kodit të Procedurës Civile, pasi shërbimi përbarimor nuk është paguar dhe, për rrjedhojë, gjykata duhet të vendoste “Anulim, pezullim i veprimit përbarimor”.
146. Në këto kushte nuk janë konstatuar *indicie* për thellimin e hetimit, pasi denoncimi nuk referon ndonjë provë apo shkelje procedurale konkrete nga subjekti i rivlerësimit dhe ka të bëjë kryesisht me themelin e çështjes gjyqësore<sup>58</sup>.

### **8. Denoncimi nr. \*\*\* prot., datë 6.5.2021, nga shoqëria “O. G.” sh. a.**

147. Shoqëria “O. G.” sh. a. ka depozituar denoncimin, në të cilin ngre pretendime për shkelje procedurale të rënda nga subjekti i rivlerësimit, pasi nuk është njoftuar rregullisht nga gjykata në lidhje me procesin gjyqësor me objekt “detyrimin e palës së paditur të paguajë në favor të palës paditëse dëmin e plotë material dhe pasuror, në makineri pajisje lëndë të parë, ndërtesë etj., të shkaktuar nga rënia e zjarrit, si dhe fitimin e munguar”, proces në të cilin denoncuesi ka qenë i paditur.
148. Në përgjigje të pyetësorit nr. 2<sup>59</sup>, në datën 23.7.2021, subjekti, në lidhje me shkaqet e shtyrjes së seancave përgatitore, ka parashtruar se asnjëra prej seancave gjyqësore nuk është shtyrë për shkak të mungesës së saj, por për shkak të mosparaqitjes së palëve, si dhe ngarkesës së subjektit për shkak të mungesave në organikën e gjykatës. Gjykimi i

<sup>58</sup>Përgjatë hetimit administrativ ka rezultuar se denoncuesi ka paraqitur ankim ndaj vendimit të dhënë nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kavajë, e cila me vendimin nr. \*\*\* regj. them., datë 8.4.2019, ka vendosur rrëzimin e kërimit të palës paditëse për pezullimin e ekzekutimit të titullit ekzekutiv. Në vijim ka paraqitur ankim në Gjykatën e Apelit Durrës lidhur me pretendimet e tij, e cila me vendimin nr. \*\*\*, datë 22.5.2019, ka vendosur “Lënien në fuqi të vendimit datë 8.4.2019, vendim të ndërmjetëm me objekt” Pezullimin e ekzekutimit të titullit ekzekutiv” të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kavajë. Gjithashtu, denoncuesi ka paraqitur rekurs në Gjykatën e Lartë, e cila nëpërmjet vendimit nr. \*\*\*, datë 10.2.2021, ka vendosur “Mospranimin e rekursit të paraqitur nga pala paditëse shoqëria tregtare ‘D’ sh.p.k.”.

<sup>59</sup>Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kavajë, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 7.6.2021, ka bërë me dije se çështja e sipërcituar është ende në gjykim. Në vijim, nëpërmjet pyetësorit nr. 2, subjekti ka deklaruar sa vijon: “Në datën 1.10.2020, nëpërmjet vendimit të ndërmjetëm për kryerjen e veprimeve paraprake subjekti proceduar me njoftimin e palëve, nëpërmjet shërbimit postar në adresat e përcaktuara nga pala paditëse në padi, duke iu bërë me dije të drejtën për të lëshuar deklaratën e mbrojtjes jo më vonë se 30 ditë nga njoftimi. Më 10.11.2020 ka mbërritur njoftimi për padinë dhe provat shoqëruese, si dhe për të lëshuar deklaratën e mbrojtjes palës së paditur O. sh.a. dhe kjo e fundit më 7.12.2020 ka paraqitur deklaratën e mbrojtjes në gjykatë. Subjekti ka deklaruar se referuar natyrës së gjykimit, si dhe pretendimit të palës paditëse në padi dhe prapësimeve të të paditurve të parashtruara në deklaratën e mbrojtjes është marrë vendim për kryerjen e akt ekspertimit teknik elektrik; akt ekspertimit vlerësues të makinerive; akt ekspertimit të vlerësimit të pasurive të paluajtshme; akt ekspertimit kontabël. Pas konsultimit me anëtarët e tjerë të trupit gjykues, në veprime paraprake më 6.4.2021 është proceduar me caktimin e ekspertëve të fushave përkatëse, caktim i të cilëve është kryer sipas parashikimeve të nenit 224/a të Kodit të Procedurës Civile, i cili parashikon se ekspertët zgjidhen nga një regjistër elektronik i personave të licencuar, i cili administrohet dhe publikohet nga Ministria e Drejtësisë. Vendimet për caktimin e ekspertëve janë marrë në Dhomë Këshillimi. Në dispozitivin e secilit vendim palëve iu është bërë me dije e drejta për të parashtruar kërkesa, kundërshtime apo arsye të mundshme konflikti interesi, në lidhje me ta, në referim të nenit 72 të Kodit të Procedurës Civile. Është urdhëruar sekretaria gjyqësore që këto vendime të ndërmjetme t’ua komunikonte palëve. Seanca përgatitore e datës 21.4.2021 është shtyrë për t’i lënë kohë palës së paditur për të depozituar kërkesën për përjashtimin e subjektit. Ndonëse nga ana e saj është argumentuar se në seancën e asaj dite do të vijohej vetëm me betimin e ekspertëve dhe jo me caktimin e detyrave për ta, pasi ato do të caktoheshin pas paraqitjes së provave, sërish përfaqësuesja e palës së paditur ka insistuar për të kërkuar përjashtimin; legjislatori ka parashikuar se gjykimi nuk pezullohet edhe në rastin e paraqitjes së kërkesës për përjashtim (neni 75/5) të Kodit të Procedurës Civile nga ana e subjektit është ndërprerë seanca për t’i dhënë mundësi palës së paditur për të paraqitur kërkesën për përjashtim dhe seanca e radhës është planifikuar për t’u zhvilluar më 27.4.2021, ora 12:30. Seanca e datës 27.4.2021 është shtyrë për t’i lënë mundësi trupit tjetër gjykues për t’u shprehur mbi kërkesën për përjashtimin e subjektit. Seanca e ardhshme është planifikuar për në datën 18.5.2021. Seanca e datës 18.5.2021 është shtyrë me kërkesë të palës së paditur për marrjen e provave që nuk kishte mundur t’i siguronte, si dhe për të marrë prova nga të tretët, të cilët janë kërkuar nga pala e paditur dhe janë vlerësuar të nevojshme për vijimin e gjykimit të çështjes. Seanca e datës 9.6.2021 është shtyrë për t’u lënë kohë palëve për t’u njohur me provat e paraqitura rishtas nga institucionet e tjera, seanca e ardhshme ishte planifikuar për në datën 2.7.2021. Seanca e datës 2.7.2021 është shtyrë me kërkesë të palës së paditur me qëllim marrjen e provave të kërkuara nga pala e paditur O. sh.a., të vlerësuar si të nevojshme edhe nga gjykata. Seanca e ardhshme është planifikuar për në datën 14.9.2021”.

çështjes, sipas saj, është bërë në përputhje me parashikimet e një procesi të rregullt gjyqësor, në respektim të parimeve të një gjykimi të drejtë, të paanshëm dhe objektiv, të zhvilluar mbi bazën e parimit të kontradiktoritetit dhe barazisë së armëve, brenda një afati të arsyeshëm, në përputhje me parashikimet ligjore që përcakton Kodi i Procedurës Civile në nenet 158, 158/a dhe 158/b të tij<sup>60</sup>.

#### **9. Denoncimi nr. \*\*\* prot., datë 1.8.2018, i shtetasit N. L.**

149. Shtetasi N. L. ka depozituar denoncimin, në të cilin ngre pretendime për vendimmarrje joprofesionale nga ana e subjektit të rivlerësimit, në vendimin nr. \*\*\*, datë 20.6.2018, për çështjen me objekt “pjesëtim pasurie”, ku është vendosur “Pranimi i padisë”, ndërsa për personin e tretë është vendosur se ai nuk mund të konsiderohet pronar, pasi mënyrat e fitimit të pronësisë janë qartësisht të përcaktuara në ligj, por i ka njohur atij të drejtën e kërimit të shumës së paguar për shlyerjen e kredisë. Denoncuesi ka pretenduar se gjykata nuk ka vepruar drejtë në thirrjen e djalit të tij në këtë proces, pasi ai nuk ka qenë pronar i sendit në pjesëtim, por pronarë kanë qenë denoncuesi dhe bashkëshortja e tij.
150. Nisur nga sa më sipër, nuk janë konstatuar *indicie* për thellimin e hetimit, pasi denoncimi nuk referon ndonjë provë apo shkelje procedurale konkrete nga subjekti i rivlerësimit, por ka të bëjë kryesisht me themelin e çështjes.

#### **FAKTE TË NJOHURA BOTËRISHT**

151. Komisioni i Pavarur i Kualifikimit është vënë në dijeni nga mjetet e informimit publik lidhur me një artikull të publikuar në disa media *online*<sup>61</sup>, nga analizimi i të cilit në mënyrë të përmbledhur ka rezultuar sa vijon: “*Operacioni ‘Forca e Ligjit’ kishte zbuluar dhe arrestuar një bandë zyrtarësh dhe biznesmenësh, që ishin përfshirë në skemën e tjetërsimit të plazhit të Spillesë, përfshirë këtu edhe poligonin e aviacionit ushtarak. Mediat e sipërcituara janë shprehur se gjyqtarja Goxha bëri ‘drejtësi’ vetëm për një postier, ndërsa për një biznesmen apo kryebashkiakun e Rrogozhinës, nuk gjeti prova*”.
152. Nga shqyrtimi i vendimit<sup>62</sup> që lidhet me çështjen objekt denoncimi, ka rezultuar se Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Kavajë ka dërguar në gjykim çështjen penale nr. \*\*\*, viti 2017, ndaj të pandehurve I. K., i akuzuar për veprën penale “pastrim i produkteve të veprës penale veprimtarisë kriminale” në bashkëpunim, vepër penale e parashikuar nga germa “c”, e nenit 287, të Kodit Penal dhe shtetasi G. B. i akuzuar për veprën penale “shpërdorim të detyrës”, parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal. Persona të interesuar në këtë proces kanë rezultuar shtetasit J. Zh., i hetuar për veprat penale “shpërdorim të

<sup>60</sup>Subjekti ka paraqitur procesverbalet e seancave gjyqësore, fletëthirrjet, vendimet e ndërmjetme, statistikat e gjykatës, urdhrat për karantinimin, për gatishmërinë.

<sup>61</sup>Denoncim nga City News Albania në linkun <https://www.cna.al/2021/02/23/skandali-i-tokave-ne-bregdet-gjyqtarja-shfryu-operacionin-forca-e-ligjit/>; denoncim nga portali Shqiptarja.com <https://shqiptarja.com/lajm/ekskluziveskandali-i-tokave-peshqit-e-medhenj-cajne-rrjeten-e-drejtises-shqiptare/>; denoncim nga psfrike.al <https://pafrike.al/forca-e-ligjit-qe-duam-zyrtaret-qe-abuzuan-me-tokat-ne-spille-jane-te-lire-ja-kush/>; denoncim nga portali lapsi.al në linkun <https://lapsi.al/2018/11/02/skandali-i-tokave-ne-spille-i-vetmi-i-akuzuar-nje-postier/>; denoncim nga bulevardionline.com në linkun <https://bulevardionline.com/tjetersimi-i-pronave-ne-spille-zyrtaret-dhe-te-akuzuarit-cajne-rrjeten-e-drejtises/>; denoncim nga portali sot.com në linkun <https://sot.com.al/aktualitet/tjetersimi-i-36-ha-toke-ne-spille-prokuroria-e-kavajes-kerkon-28-vite-burg-9-ish-zyrtaret/>; denoncim nga portali starplustv.com në linkun <https://www.starplustv.com/tjetersimi-i-pronave-ne-spille-prokuroria-kerkon-28-vite-burgim-per-9-zyrtaret/>.

<sup>62</sup>Vendim nr. \*\*\*, datë 5.10.2018, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kavajë.

detyrës” dhe “falsifikim të dokumenteve” dhe F. Q., i hetuar për veprën penale “falsifikim të dokumenteve”, është dërguar nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor. Kjo çështje është shqyrtuar nga subjekti si gjyqtare e vetme<sup>63</sup>.

### **Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit**

153. Në lidhje me çështjen penale në ngarkim të të pandehurve B. N., ish-kryetar i Bashkisë Rrogozhinë dhe shtetasve A. A., A. A., A. K., A. D., Sh. D. dhe B. N., të përmendur nga media *online*, subjekti ka deklaruar se këta shtetas nuk janë gjykuar prej saj, por nga gjyqtarë të tjerë, pasi vendimi ndaj këtyre shtetasve është marrë në datën 23.2.2018, ndërkohë që subjekti ka deklaruar se ka qenë gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Berat deri në muajin qershor të vitit 2018.
154. Nëpërmjet vendimit nr. \*\*\*, datë 5.10.2018, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kavajë, subjekti ka vendosur pranimin e kërkesës së Prokurorisë në lidhje me pushimin e çështjes penale në ngarkim të personave nën hetim J. Zh. dhe F. Q. dhe dërgimit në gjyq ndaj të pandehurit G. B.. Ndërsa në lidhje me të pandehurin I. K., ndryshe nga sa është kërkuar nga organi i akuzës, nga ana e subjektit është pushuar gjykimi për mungesë të prova ndaj tij.

### **Vlerësimi i Komisionit**

155. Në lidhje me vendimmarrjen e subjektit ndaj shtetasve të përmendur, pas administrimit të dokumentacionit të paraqitur nga subjekti ka rezultuar sa vijon:
- i. Lidhur me shtetasin B. N., ish-kryetar i Bashkisë Rrogozhinë, të përmendur në media, nga dokumentacioni i paraqitur nga subjekti, konkretisht vendimi nr. \*\*\*, datë 29.10.2018, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kavajë, ky vendim është dhënë nga një tjetër trup gjykues.
  - ii. Ndërsa për sa i përket shtetasit G. B., të përmendur gjithashtu në media, nga subjekti, me vendimin nr. \*\*\*, datë 5.12.2018, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kavajë është vendosur: “*Deklarimi fajtor i të pandehurit G. B., për kryerjen e veprës penale ‘shpërdorim të detyrës’*”<sup>64</sup>.

---

<sup>63</sup>Në lidhje me akuzën e prokurorisë ndaj shtetasit I. K., gjykata ka vlerësuar se për kryerjen e veprës penale “pastrim të produkteve të veprës penale”, parashikuar nga germa “c” e nenit 287, është e pambështetur në prova, ndaj ka vendosur pushimin e çështjes penale dhe shuarjen e masës së sigurimit “arrest në burg”, në ngarkim të tij.

Në lidhje me përgjegjësinë penale të të pandehurit G. B., gjykata ka arsyetuar se veprimet dhe mosveprimet përkatëse të të pandehurit për akuzën penale të parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal dhe individualizojnë si autor të mundshëm të kësaj veprë penale.

Në lidhje me kërkesën për pushimin e çështjes penale ndaj shtetasit J. Zh., gjykata ka vlerësuar se aktet noteriale të hartuara prej tij janë nënshkruar bazuar në nenin 54 të ligjit nr. 7829/1994 “Për Noterinë”, i ndryshuar, dhe se nuk janë konstatuar elementë të veprës penale as për veprën penale “shpërdorim të detyrës”, parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal, as për veprën penale “falsifikim të dokumenteve”, parashikuar nga neni 186 i Kodit Penal. Me pushimin e çështjes penale gjykata ka urdhëruar edhe shuarjen e masës së sigurimit “detyrim për t’u paraqitur në policinë gjyqësore”, të parashikuar nga neni 234 i Kodit të Procedurës Penale.

Në lidhje me shtetasin F. Q., gjykata ka vlerësuar bazuar në përfundimin e prokurorisë ndaj ka vendosur pushimin e çështjes, pasi nuk është provuar kryerja e veprës penale “falsifikim të dokumenteve” të parashikuar nga neni 186 i Kodit Penal.

<sup>64</sup>Nëpërmjet vendimit nr. \*\*\*, datë 5.12.2018, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kavajë, subjekti ka vendosur: “Deklarimi fajtor i të pandehurit G. B., për kryerjen e veprës penale ‘shpërdorim të detyrës’, parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal dhe në bazë të këtij neni dënimin e tij me 1 vit e 3 muaj burgim. Në zbatim të nenit 406/1 të Kodit të Procedurës Penale, i ulet 1/3 e dënimit dhe përfundimisht i pandehuri G. B. dënohet me 10 muaj burgim. Në aplikim të nenit 59 të Kodit Penal, urdhërohet pezullimi i ekzekutimit të dënimit me burgim ndaj të pandehurit G. B. duke e vënë në provë të pandehurin për një periudhë kohe prej 20

- iii. Për sa i takon të pandehurit I. K., nga dokumentacioni i paraqitur nga subjekti ka rezultuar se nuk ka pasur prova të mjaftueshme për ngritjen e akuzës ndaj tij.
  - ii. Vendimmarrja e subjektit, si për sa i takon dërgimit në gjyq ashtu edhe për sa i takon pushimit të gjykimit të akuzës është konfirmuar edhe nga ana e trupave të tjerë gjykues, të gjykatave më të larta<sup>65</sup>.
156. Nisur nga sa më lart, duke vlerësuar përmbajtjen e denoncimit në fjalë në raport me sa ka rezultuar nga aktet dhe dokumentet e administruara, si dhe duke mbajtur në vëmendje shpjegimet e paraqitura nga subjekti, trupi gjykues çmon se edhe në këtë rast nuk janë konstatuar shkelje procedurale apo mangësi profesionale të subjektit të rivlerësimit në ushtrimin e funksionimit të saj.
157. Trupi gjykues, në këto kushte, pasi ka çmuar faktet dhe rrethanat që lidhen me aktet e shqyrtuara më herët nga KLGJ-ja, si dhe denoncimet nga publiku, nga një vlerësim i përgjithshëm i kriterit profesional, si dhe duke mbajtur në konsideratë faktin se nuk kanë rezultuar shkelje të rënda të subjektit, trupi gjykues çmon se referuar nenit 44 të ligjit nr. 84/2016, subjekti i rivlerësimit Diamela Goxha është e aftë dhe ka arritur një nivel kualifikues lidhur me vlerësimin e aftësive profesionale, sipas parashikimit të dispozitave ligjore përkatëse.

### **KONKLuzion Përfundimtar**

Trupi gjykues, sipas parashikimit të germës “a”, të nenit 59/1, të ligjit nr. 84/2016, arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit Diamela Goxha:

- a. ka arritur një nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë;
- b. ka arritur një nivel të besueshëm në kontrollin e figurës;
- c. ka arritur një nivel kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale.

Komisioni, në këto kushte, bazuar në provat që disponon në vlerësimin e çështjes në tërësi, si dhe në bindjen e brendshme, arrin në konkluzionin që subjekti i rivlerësimit Diamela Goxha duhet të konfirmohet në detyrë.

---

muajsh, me kusht që gjatë kësaj kohe i pandehuri të mos kryejë veprë tjetër penale dhe të mbajë kontakte me Shërbimin e Provës”.

<sup>65</sup>Vendimi i subjektit ka rezultuar i ankimuar në Gjykatën e Apelit Durrës, e cila me vendimin nr. \*\*\*, datë 23.11.2018, ka vendosur: “Miratimin e vendimit nr. \*\*\*, datë 23.2.2018, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kavajë për shtetasit A. A., A. K., A. D., Sh. D. dhe B. N.. Për shtetasin A. A. rrëzimin e kërkesës së Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kavajë për caktimin e masës ndaluese, të parashikuar nga neni 242 i Kodit të Procedurës Penale”. Në përgjigje të pyetësorit nr. 2, të dërguar nga subjekti, kjo e fundit ka paraqitur vendimin nr. \*\*\* i regj. themeltar nr. \*\*\*, i vendimit të Gjykatës së Lartë, nga ku ka rezultuar se kundër vendimit të Gjykatës së Apelit Durrës ka ushtruar rekurs personi nën hetim A. K., duke kërkuar prishjen e vendimeve dhe pushimin e çështjes ose prishjen e vendimeve dhe kthimin e saj për rigjykim. Gjithashtu, ka ushtruar rekurs prokurori pranë Gjykatës së Apelit Durrës i cili kërkon: prishjen e vendimit të Gjykatës së Apelit Durrës dhe lënien në fuqi të vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kavajë për personin nën hetim A. A.. Konkretisht, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë ka vlerësuar se rekursi e paraqitur nga prokurori pranë Gjykatës së Apelit Durrës dhe personi nën hetim A. K. nuk përmbajnë ndonjë prej shkaqeve të përcaktuara në nenin 432 të Kodit të Procedurës Penale, në pikën 1 të tij, sipërpërmendur dhe, për rrjedhojë, nuk mund të pranohen. Për rrjedhojë, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, mbështetur në nenin 433, të Kodit të Procedurës Penale, ka vendosur: “Mospranimin e rekurseve të paraqitura nga prokurori pranë Gjykatës së Apelit Durrës dhe personi nën hetim A. K., kundër vendimit nr. \*\*\*, datë 8.3.2018, të Gjykatës së Apelit Durrës”.

## **PËR KËTO ARSYE,**

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, bazuar në pikën 5, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016, pasi u mbledh në dhomë këshillimi, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, në bazë të germës “a”, të pikës 1, të nenit 58 dhe pikës 1, të nenit 59, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

### **V E N D O S I:**

1. Konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit Diamela Goxha, gjyqtare pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kavajë.
2. Vendimi, i arsyetuar me shkrim, i njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë, si dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit në përputhje me pikën 7, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016.
3. Ky vendim mund të ankimohet në Kolegjin e Posaçëm të Apelit nga Komisioneri Publik dhe/ose subjekti i rivlerësimit, 15 ditë nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit.
4. Ankimi depozitohet në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit.

Ky vendim u shpall në datën 27.9.2021.

### **ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES**

**Brunilda BEKTESHI**

**Kryesuese**

**Lulzim HAMITAJ**

**Relator**

**Etleđa ÇIFTJA**

**Anëtare**

*Sekretare gjyqësore*

*Orjanda Liçi*